

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME JOLYON NAEGELE

Prishtinë | Data: Maj, 2017

Kohëzgjatja: 118 minuta

Të pranishëm:

- Jolyon Naegele (I intervistuari)
- Anna Di Lellio (Intervistuesja)
- Donjeta Berisha (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

Anna Di Lellio: A mund të filloni me emrin tuaj, ku dhe kur jeni lindur dhe disa kujtime të familjes dhe fëmijërisë tuaj?

Jolyon Naegele: Unë jam lindur në New York, në qytetin e New York-ut, Manhattan, në vitin 1955, jam rritur në New York. Prindërit e mi ishin emigrantë, babai u lind në Gjermani ndërsa nëna në Angli. Babai im është gjysëm-hebre dhe ishte evakuuar për në Angli në vitin 1938, me një të ashtuquajtur “Kindertransport” së bashku me shumë fëmijë të tjerë me prindër të përzier apo tërësisht hebrej. Nën ligjin gjerman, ai njihet si gjysëm-arian. Ai emigroi me prindërit e tij, të cilët dolën haptazi në vitin që pasoi, dhe me vëllezërit e motrat e tij, ai emigroi me njërin nga vëllezërit e tij dhe me babain në vitin 1940 gjatë betejës së Britanisë në New York.

Nëna ishte evakuuar me disa nga shokët saj të klasës në vitin 1941 apo aty diku, ose ‘40 për në Kanada ku ajo përfundoi shkollën dhe pastaj shkoi në Shtetet e Bashkuara për një vit apo dy, për t’u kthyer në Britani në vitin 1944. Kështu që, babai kishte mësuar anglisht në Angli, nëna ime ishte angleze, prandaj theksi im është më shumë si ai Atlantikut verior sesa si ai në Manhattan. Unë... të dy prindërit e mi janë artistë, gjyshi im ishte piktor poashtu, prandaj ne jemi rritur në një ambient kreativ, unë dhe tre vëllezërit e motrat e mia, por duke qenë më i madhi, e dija çfarë doja qysh në moshë të re dhe kur u bëra 15 vjeç udhëtova vetëm për në Mbretërinë e Bashkuar për të vizituar të afërmit dhe për të parë pak nga bota. Në moshën 18 vjeçare, udhëtova i vetëm për në kontinentin e Evropës vetëm për disa muaj, duke qëndruar nëpër hostele të rinjsh, pastaj edhe me shokë e me të afërm dhe për herë të parë kam vizituar Evropën Lindore, Çekosllovakinë, kam parë perden e hekurt, realitetin për të cilin kisha lexuar kaq shumë dhe për të cilin isha kaq kurioz, më në fund pashë gjithçka me sytë e mi dhe vitin që pasoi, studiova në Londër, në Mbretërinë e Bashkuar. Kam studiuar Gjuhë dhe Letërsi Çeke. Në vitin e tretë të universitetit, viti i fundit jashtë shtetit, unë isha përndryshe edhe kryetar i marrëdhënieve ndërkombëtare, pastaj vazhdova duke u fokusuar në Marrëdhëniet Ndërkombëtare siç thashë, në Evropën Perëndimore, fillimisht si i diplomuar në Bolonjë, pastaj në Universitetin “Johns Hopkins” në Washington.

Vizita ime e parë në Ballkan ishte gjatë kohës kur po studioja në Bolonjë, një grup studentësh së bashku me një profesor shkuan në Beograd për të qëndruar një javë në Institutin Jugosllav të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ku profesori Ivo Mates shpjegoi (qeshë) situatën gjeopolitike të Jugosllavisë, dhe ne në fillim, fillimisht, kjo ishte hera e parë që kisha bisedën më sipërfaqësore rreth Kosovës, dhe kjo ndodhi në vitin 1977, dhe Kosova realisht nuk ishte në hartën e askujt jashtë rajonit të afërt. Në vitin 1980, në fund të këtij viti, unë u zhvendosa në Evropë për të punuar si reporter për “Business International” [Biznesi Ndërkombëtar] e cila kishte një të përjavshme “Business Eastern Europe” [Biznesi në Evropën Lindore] dhe një të përmuajshme “Doing Business in Eastern Europe” [Të Bërit Biznes në Evropën Lindore]. Zyra e tyre ishte në Vjenë dhe unë fillova të bëj udhëtime të rregullta në Evropën Lindore. Pasi magjistrova, udhëtova me tren për në Bashkimin Sovjetik vetëm për disa, disa javë, ku pata rastin të takoj njerëz, të testoj rusishten time...

Anna Di Lellio: Cilat ishin përshtypjet tuaja për Jugosllavinë në vitin 1977?

Jolyon Naegle: Çfarë pashë në vitin 1977 ishte ajo që mund të shihja nga treni në mes të kufirit Italian dhe Beogradit e anasjelltas, dhe gjithçka dukej relativisht e pazhvilluar dhe tradicionale. Vetë Beogradi më kujtonte disa qytete në Çekosllovakia, me përjashtimin që ishte... të paktën në Terazije ti mund të blije një gazetë perëndimore rinore, përpara, nga një shtand gazetash, përpara “Hotel Moskvës”. Ishte i gjallë, interesant, më i lirë se vendet që i kisha vizituar në Bllokun Sovjetik. Ishin disa... në kuptimin e të mirave për konsumatorin, dyqanet që ishin hapur nuk shihje gjëra si në Pragë të cilët ishin para në atë lojë për pesë apo dhjetë vjetë, dhe po, çmime të arsyeshme, dyqanet e fermerëve ishin mirë të furnizuar e të tjera.

Fillova të punoj si korrespondent për “Zërin e Amerikës” në vitin 1984, dhe shpejt pas kësaj fillova të udhëtoj për në Jugosllavi. Unë isha me bazë në Vjenë, fokusi im ishte praktikisht e gjithë Evropa Lindore dhe si amerikan, më duhej një vizë jugosllave. Mora pjesë në një seancë gjyqësore të një kriminelit kroat nga Lufta e dytë botërore, e cila ishte, unë mora pjesë më duket vetëm në një ose dy dëgjime, por megjithatë, kjo ishte njëfarë përvoja. Në fakt, shpejt pas kësaj, më në fund mora patent shoferin, meqë me duhej të vozisja shumë nëpër Jugosllavi dhe rajon, erdha në Kosovë në prill të vitit 1985 me makinë dhe u impresionova me peizashin, me ekzoticitetin e vendit, ishte... më pak evropian se të gjitha vendet në të cilat kisha qenë. Isha ende i ri dhe nuk kisha udhëtuar aq shumë në rajon, prandaj kishte shumë gjëra për të cilat nuk kisha ndonjë shpjegim, shumë gjëra që pashë. Dhe komunikimi ishte i vështirë. Shumë, shumë pak njerëz flisnin anglisht në Prishtinë ato ditë.

Vala e punëtorëve mysafirë në Zvicër dhe Gjermani sapo fillonte, kështu që po, shihje pllaka zvicerane të licensës veçanërisht në Prizren me rrethinë. Nuk flisja fare shqip, as serbisht por mund të kuptoja pak duke u bazuar në njohuritë e mia të çekosllovakishtes, rusishtes, dhe unë... udhëtova nëpër vend dhe intervistova njerëz... u dashurova në Prizrenin, u riktheva në Prizren dhe Pejë e Prishtinë disa muaj më pas në vjeshtë, besoj në shtator, për arsye se isha kurioz dhe ia vlente të shkruhej për të. Isha sfiduar përgjatë raportimit në Rumani, kisha folur me një diplomat amerikan i cili më tha se isha duke humbur kohë duke ndjekur çështjet e minoritetit hungarez të cilat, e dini, “Shko në Kosovë nëse

dëshiron të përballesh me diçka, mos provo të nxisësh telashe këtu”. Dhe unë nuk po provoja të nxisja telashe, thjesht po provoja të kuptoja (buzëqeshë) marrëdhëniet, pse Causesku po angazhohej në ato që ne e dijme qartazi që ishin aktivitete vetëshërbyese populiste për të nënçmuar komunitetin hungarez atje dhe, dhe diçka po ndodhte këtu... në një, në një formë tjetër, por rezultati përfundimtar ishte disi i njëjtë.

Në secilën vizitë pasuese kishte më shumë policë, më shumë transportues të blinduar të personelit të parkuar në parkun prapa “Grand Hotel”, aty ku sot është skulptura “Heroinat”, ishte një parking i makinave të Ministrisë së Punëve të Brendshme atëbotë, në fakt u bë i tillë, sepse herën e parë që kisha ardhur këtu, ai kishte qenë thjesht park dhe në vitin 1998 kur erdha njëherë apo dy, liria e njeriut për të lëvizur ishte kufizuar aq shumë sa që duhej pasur leje nga Sekretariati për Informacion i Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës dhe Metohisë për të udhëtuar nëpër krahinë, me komunat e specifikuar ku lejohej dhe nuk lejohej të shkohej të shkruajtura me dorë... jo vetëm komunat, por edhe qytezat, dhe unë kisha një leje ku thuhej, “Nuk i lejohet shkuarja në Junik”. Ndërsa unë shkova në Junik ku u ndalova nga policia. Pata përshtypjen se oficeri i policisë veçanërisht nuk kishte talent të lexonte serbisht dhe tha, “Oh, oh, oh, Junik, po, mirë, sigurisht”. (Qeshë) Ky ishte pikërisht vendi ku nuk duhej të isha. Jo që kisha kaluar në ndonjë kaçak, apo pasardhësit e tyre, por çfarë zbulova atje, gjë e cila ishte zhdukur në vitin ‘99, ishte një mënyrë shumë tradicionale e jetesës. Pa asfalt, gjysmën e kohës, pa energji elektrike, gra me veshje tradicionale, familje që jetonin nëpër kulla dhe në Junik kishte më shumë kulla se kudo në Kosovë. Ishte si një udhëtim në të kaluarën e që nuk ishte dëmtuar nga ajo që ne tani e quajmë globalizëm, e që më parë ishte quajtur modernizim ose amerikanizim dhe...

Anna Di Lellio: A kishit lexuar ndopak...

Jolyon Naegele: Për çfarë?

Anna Di Lellio: Po mendoj, ishit duke udhëtuar, a kishit lexuar diçka që iu kishte përgatitur për ta kuptuar Kosovën, po mendoj, unë e di që ju jeni goxha i lexuar kështu që do të imagjinoja...

Jolyon Naegele: Po, ishte “*Black Lamb Great Falcon*”¹, apo çfarëdo “*Grey Falcon*”, ose sido që quhet, nga Rebecca West. Po, kisha lexuar kapitujt përkatës nga vizita ime e dytë apo përgjatë vizitës sime të dytë, por ajo kishte një qasje shumë të veçantë dhe miopike për vendin të bazuar në atë se me kë po udhëtonte dhe me kë kishte folur.

Ehm... kisha lexuar më shumë për Shqipërinë dhe për të qenë i sigurtë, isha më shumë i interesuar të shkoja në Shqipëri sesa në Kosovë, por kjo ishte në vitet 1980, atëherë kjo as që vinte në shprehje për një shtetas amerikan. Prandaj, isha më kurioz rreth kulturës shqiptare si të tillë dhe e kërkoja në Kosovë dhe Maqedoni, të vetmet vende ku ndihesha se do të mund të jetoja në një hapësirë

¹ “Black Lamb and Grey Falcon: A Journey Through Yugoslavia” [Qengji i Zi dhe Falkoi i Përhirtë: Një udhëtim në Jugosllavi] është libër udhëtimi i shkruajtur nga Rebecca West, i botuar në vitin 1941 në dy vëlime nga Macmillan në Mbretërinë e Bashkuar dhe nga The Wiking Press në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

tradicionale shqiptare, apo këtu në Dibër, Dibër në Maqedoni, në fakt gati më shumë atje, ndikimi ishte i dukshëm në qytezë, nuk ishte njëlloj me pjesën tjetër të Maqedonisë së atëhershme, ishte tërësisht ndryshe. Shumica e shqiptarëve kishin emigruar në Ishujt Staten dhe dërgonin shumë para, prandaj qyteti ka ndryshuar. Por, kështu që, po, kisha lexuar pak por nuk kishte edhe aq shumë material në dispozicion, ishte më shumë një çështje e të diskutuarit rreth Kosovës me gazetarë të tjerë që kishin qenë këtu, të cilët e dinin kush ishte kush, kush e dinte çfarë... çfarë dileme ishte për Beogradin dhe cilat ishin përshtypjet e Zagrebit e Ljublanës. Veçanërisht Viktor Meier nga “Frankfurter Allgemeine Zeitung” i cili e kishte mbuluar rajonin që nga viti 1956 e që vdiq para disa vitesh, dhe korrespondenti i “Reuters” në Beograd atë kohë dhe disa të tjerë. Kështu që, kishte njerëz që më tregonin ato që ishin të rëndësishme, atë që ishte interesante por krahasuar me të gjitha pjesët tjera të rajonit, me të vërtetë nuk kishte literaturë të fokusuar në Kosovë.

Sidoqoftë, çfarë bëra unë, meqë mund të lexoja disi serbisht me një fjalor, u abonova në “Jedinstvo” e cila ishte gazetë ditore atë kohë, dhe shikoni, ishin tri të përditshme, “Jedinstvo,” “Rilindja,” dhe “Tan,” dhe duke marrë parasysh faktin që unë as nuk flisja as lexoja shqip apo turqisht, disi mund të çaja përtej “Jedinstvo” dhe këto kopje u grumbulluan në tavolinën time të punës nga viti 1987, ‘86 ose ‘87 e tutje dhe ishte koha e inflacionit, kështu që ne paguam abonimin për një vit dhe pas gjashtë muaj, ata erdhën nga Beogradi, distributorët, dhe thanë se iu duhej e njëjta sasi përsëri sepse i kishin harxhuar (qeshë) paratë, për arsye se nuk i kishin mbajtur në valuta fizike, ata menjëherë i kishin transferuar ato në dinarë në fillim të abonimit, por nuk iu kishin mjaftuar për gjithë vitin. Kështu që, eventualisht, pas disa vitesh e anulova, por ndërkohë, isha i aftë të ndiqja zhvillimet në “Jedinstvo” në “NIN” dhe “Danas” dhe gjetkë, dhe mund të kuptoja pak në “Vreme” kur filloi të botohet, të kuptoja pak mbi atë se si media serbe po e mbulonte Kosovën dhe histerinë në rritje këtu në fund të viteve të ‘80-ta.

Pastaj erdha këtu në vitin 1989, dy herë në pranverë, një herë afër Pashkëve... dhe mendoj, po kjo ishte kur vizitova Junikun për herë të parë dhe pastaj për Vidovdan² ku i pashë me sy festimet në Graçanicë, natën para se të vinte Millosheviçi, e cila mund të përmblihet me shumë serbë të dehur në rrugë dhe bllokim. Mediat u dërguan atje me autobus por e vetmja mënyrë për t’u kthyer ishte në këmbë. Po mendoj, pashë atë që kisha për të parë brenda rreth 20 minutash dhe pastaj u ktheva në këmbë për në Prishtinë duke ecur kodrave. Dhe ditën tjetër na dërguan në Gazimestan ku Millosheviçi ishte sjellur me helikopter. Ne na mbajtën {shpjegon me gjeste} nën një tendë. E kam xhiruar, ende e kam diku kasetën e fjalimit të tij famëkeq por çfarë më është dukur interesant, duke qenë se kisha mbuluar diktatorët nëpër rajon, sidomos Causeskun, ishte frika e masës së shteti, se aparati shtetëror kishte...

Njëlloj si Causeskun, Millosheviçi u mbajt larg masës dhe në anën tjetër të autostradës, e cila nuk ishte me të vërtetë autostradë në atë kohë, ishte thjesht rrugë me dy korsi. Aty ishte një fushim të përkohshëm të mjeteve transportuese të ushtrisë jugosllave që përfshinin tanke me xhyle dhe transportues të blinduar të personelit si dhe mjete tjera të ndryshme transporti të cilat i kam fotografuar dhe ende i kam ato fotografi të cilat i japin njeriut imazhin e një tentative, dyshoj... shteti

² Festë kombëtare dhe religjioze serbe që mbahet me 28 qershor, ndërsa sipas kalendarit julian me 15 qershor.

nuk e dinte realisht se ku po shkonin gjërat dhe dëshironin të trembnin. Nuk mendoj se ushtarët të cilët e përbënin atë fushim ia kishin idenë se çfarë... askush nuk më ndalonte të bëj fotografi, kujtoj se kjo ishte në vitin '89, jo '99, situata ishte krejt ndryshe. Nuk ishte e tensionuar por nuk ishte krejtësisht e relaksuar. Por armët, të ardhurat... gjithçka ishte e drejtuar në drejtimin tjetër, kah Obiliqi, kah, jo kah po mbahej tubimi, por në anën tjetër të rrugës dhe askush nuk provonte ta ndalonte.

Unë... më vonë atë ditë, së bashku me interpretuesen time e cila ishte Laura Silber, e cila vazhdoi duke u bërë një gazetare e njohur, apo jo, dhe e cila ishte e lidhur me "The New York Times", jo më falni, e cila ishte e lidhur me Amerikën Veriore dhe më pas edhe me "Financial Times". Shkuam për të vizituar Ibrahim Rugovën, të cilin e kisha intervistuar njëherë ose dy dhe njëra nga këto intervista ishte publikuar tashmë në "Drita" në Shqipëri me emrin tim, por duke më identifikuar si "gazetar amerikan" [shqip], pa e përmendur "The Voice of America" [Zëri i Amerikës]. Dhe Rugova ishte shumë i lumtur, i befasuar në fakt, që kjo intervistë pati aq bujë, jo vetëm në Shqipëri por edhe këtu, ai deri atëherë nuk e kishte ditur sa njerëz ishin duke dëgjuar realisht derisa njerëzit filluan t'i afroreshin vazhdimisht në rrugë duke i thënë, "Kam dëgjuar intervistën tënde në 'Voice of America'". Kështu që, pasi e kishim vizituar në banesën e tij, pastaj, më duket se ishte pranverë, e vizituam në zyrën e tij prapa stadiumit për, ku e intervistova dhe e dërgova atë intervistë në ëashington tek "The Voice of America" së bashku me audio nga Gazimestani.

Dhe çfarë ndodhi pastaj ishte një grindje e cila eskaloi në fizike në redaksinë e "VOA" në mes të udhëheqësit të shërbimit Jugosllav, Veljkos, nuk më kujtohet mbiemri i tij, dhe udhëheqësit të shërbimit shqiptar ku... dhe e gjithë kjo erdhi deri në një luftë me grushte ku Veljko refuzonte, jo që refuzonte por, por... që t'i transmetonte elementet e intervistës së Rugovës por insistonte që intervista të mos transmetohej as nga shërbimi shqiptar e as nga ai i gjuhës angleze dhe ishte vendosur në redaksinë e lajmeve se kjo ishte dita e Serbisë dhe se nuk do ta transmetonin atë ditë por do të mund të bënin një gjë të tillë të nesërmen, nuk më kujtohet nëse Elez Biberaj, udhëheqësi i shërbimit shqiptar e transmetoi atë në shqip atë ditë apo iu desh të priste. Por tensionet ishin të larta edhe atje.

Anna Di Lellio: A mendoni se iu kujtohen personalitetet që keni takuar atë kohë, apo, përveç Rugovës?

Jolyon Naegele: Rexhep Qosja ishte gjithmonë larg, ai ishte gjithmonë në bregdetin e Adriatikut, asnjëherë në dispozicion, kështu që njerëzit me të cilët kam folur, e dini, kam folur me një gjykatës të rastit Martinoviç të cilin e kisha përcjellur në faqet e "Jedinstvo". Ky ishte një rast i famshëm i djalit me një shishe të birrës i cili pretendonte se ishte sulmuar nga shqiptarët dhe pastaj doli se ishte vetë-lënduar në mes të një fushe. Dhe kështu kam intervistuar gjykatësin e atij rasti por normal ajo që ai thoshte ishte se, "Për aq gjatë sa rasti është në proces, unë nuk mund të komentoj". Jam ulur në shumë... kam bërë intervista me zyrtarë të Sekretariatit, më duket të Sekretariatit të famshëm për Informacion [MUP], mendoj se në atë kuptim, nuk ishin impresionuese.

Kam folur me një automekanik këtu në Prishtinë, i cili dëshironte të më shëtiste, dëshironte të më dërgonte në Prizren... dhe ai më dha një prej, dy prej citateve më të mira të udhëtimit, dhe citatet më

të paharrueshme që i ruaj nga ajo epokë në Kosovë. Njëri ishte... ky ishte një burrë që kishte tetë fëmijë dhe gruaja e tij ishte shtatzënë me fëmijën e nëntë dhe ai tha, “Nuk ka asgjë më të bukur se një grua shqiptare shtatzënë me fëmijën e nëntë ose të dhjetë,” apo kështu diçka. Situata ishte shumë më ndryshe ato ditë... Ky ishte njëri nga citatet, dhe i dyti ishte, “Kur të ndodhë revolucioni, ne do të bashkohemi me Shqipërinë, do të luftojmë dhe do të bashkohemi me Shqipërinë”. Dhe unë thashë, prit një sekond, “Enver Hoxha ka vetëm disa muaj që ka vdekur”. Apo një vit atëbotë, ai ka vdekur në vitin ‘84 ose ‘85, nuk më kujtohet tani, sidoqoftë ai kishte vdekur vetëm disa muaj më parë, viti ‘85, prill, ‘85, “A e ke idenë çfarë do të thotë të bashkoheni me Shqipërinë, duke e marrë parasysh sistemin që kanë atje krahasuar me lirinë relative që keni ju këtu?” Dhe përgjigjja e tij ishte, “Ne jemi shqiptarë, mund t’i tejkalojmë të gjitha. Ne shikojmë televizion shqiptar, e shohim çfarë toke e mrekullueshme është ajo”. Eh po, kështu kishin menduar ata, edhe ai, ndër të tjerë dhe ky ishte një aspekt tjetër interesant, dhe pastaj më shumë se dhjetë vjetë më vonë, 14 vjet më vonë, në vitin ‘99 duke i intervistuar refugjatët shqiptarë nga Kosova, kosovarët në Shqipëri dhe ata ishin të shokuar nga ajo që kishin gjetur, domethënë, një numër i njerëzve kishin ardhur tashmë për të vizituar përgjatë viteve të ‘90-ta dhe u konfrontuan me realitetin i cili ishte jashtëzakonisht i ndryshëm nga ai në radio dhe në televizionin shqiptar.

Kështu që, këto ishin vizitat e mia të hershme, më falni (kollitet). Dhe pastaj gjëra të tjera filluan të zhvilloheshin: shtypja e komunitetit turk në Bullgari u shndërrua në, në fund të qershorit, menjëherë pas Vidovdanit, pothuajse në të njëjtën kohë, u shndërrua në... domethënë... shtypja ndaj minoritetit turk kishte vazhduar për disa vite, sidoqoftë më 6, 5 ose 6 qershor, Topa Zhivko dha një deklaratë në Sofje duke hapur kufinj të dhe unë kisha qenë shumë i përfshirë duke e mbuluar atë çështje prandaj shkova direkt nga Gazimestani për në Beograd... fillimisht në Prishtinë pastaj në Beograd dhe pastaj fluturova për në Stamboll ku mbulovala rrjedhën e saj, e, e saj. Dhe pastaj ishte zhvillimi në vjeshtë në Budapest, Pragë dhe Laipçig dhe kështu e mbulovala kolapsimin e komunizmit në Hungari, Çekosllovakia dhe Gjermani Lidnore e Poloni ku kisha qenë, për zgjedhje ku Solidariteti fitoi 99 nga njëqind ulëset në Senatin Polak në vjeshtë... në gusht, jo edhe kjo ka ndodhur në qershor, ishte fundjava e njëjtë me atë të fjalimit të Topa Zhivkos.

Dhe më në fund, fokusi u ngrit përsëri në Jugosllavi në vitin ‘91 siç më kujtohet, fillimi i vitit ‘91, jo, në vjeshtë të vitit ‘90 ku kishte incidente afër Liqenjve Piltvice në Kroaci, ku serbët, serbët vandalë kishin prerë pemët, bllokuar rrugët dhe kishin marrë peng turistët dhe autobusët e turistëve e kështu me rradhë. Dhe kjo po e rriste frikën se diçka do të ndodhte në Kroaci në Slloveni dhe në fund, një ditë më vonë, ata shpallën pavarësinë nga Beogradit, dhe “VOA” kishte një plan. Në atë moment unë isha korrespondent në Pragë, ishte korrespondenti i Vjenës ai që shkoi në Zagreb, unë isha në Beograd. Dhe më kujtohet teksa hyja dhe dilja nga Beogradit, një numër ndodhishë. Në, në vjeshtë, në vjeshtë, diku në vjeshtën e vitit ‘91 isha në Manastir dhe serbët pushtuan Kroacinë, lindjen e Sllovenisë e cila ishte nën zjarr artilerik dhe pa energji elektrike, pamja nuk ishte e këndshme, vizita në fshatra si Lloku, i cili ishte braktisur nga shumica, pothuajse të gjithë përpos klerikëve dhe të krisurve.

Dhe pastaj në vitin '92, në një fundjavë maji, Sarajeva po bombardohej nga forcat jugosllave ajrore, unë isha, dola për shëtitje në Kalemegdan sepse nuk kisha sinjal të radios në "Hotel Moskva" në [radio] AM për shkak të strukturës {shpjegon me duar} ose për shkak të zhurmës, jo zhurmës por ndërprerjeve. Kështu që, shkova në Kalemegdan sepse kisha dëgjuar nga reporterët që mund të arrihe sinjal në radion tënde AM nga atje, për të dëgjuar radio "Sarajevën," "BBC," "VOA," për të zbuluar çfarë po ndodhte. Dhe i dëgjova në kohë reale lutjet për ndihmë nga radio "Sarajeva" dhe i shikova njerëzit teksa kërcenin spontanisht, relativisht në Kalemegdan. Nuk e di në ia kishin idenë për atë që po ndodhte në Sarajevë, apo nëse kishin ndonjë aluzion dhe ishin thjesht në disponim të mirë, por zakonisht njeriu nuk sheh vallëzim në rrugë në mes të ditës dhe kjo që pashë nuk ishte paradë.

Një grup kolegësh gazetarë shkuan në Sarajevë e disa prej tyre nuk u kthyen kurrë. Të gjithë shkuan në një karvan atë fundjavë dhe unë vendosa të mos shkoja, sepse nëse ekziston diçka që kam mësuar si korrespondent gjatë viteve të kaluara, është se vlera jote është aq e mirë sa aftësia jote për të përçuar një tregim, dhe nëse përfundon prapa grilave ose në spital ti nuk je, ti je mish për top në atë moment. Dhe nuk është se unë nuk kisha qenë kurrë në Sarajevë më parë dhe nuk kisha raportuar për muaj me radhë, për një vit se nëse luftimet në Kroaci do të shpërndaheshin në Bosnjë, do të ishte një lojë komplet tjetër dhe atëherë me të vërtetë do të kishte banja gjaku. E dija dhe nuk shkova, dhe disa njerëz në atë karvan gjetën fundin e tyre brenda, brenda disa ditëve ose përfunduan duke u tërhequr me lëndime shumë serioze.

Më pas shkova në Bosnjë vetë përgjatë një konflikti në një rast. Dhe pata raportuar rreth tij dhe menjëherë u konfrontova me atë irritim që shumë reporterë jo vetëm nga "VOA" e përjetojnë, kur je diku ku nuk është pjesa tjetër dhe ti e ke një raport, por të gjithë të tjerët janë duke raportuar mbi diçka tjetër dhe redaktorët e tu duan që ti të raportosh mbi diçka tjetër e jo mbi atë që ti je duke përjetuar. Isha i ulur në një qytezë e cila ishte e rrethuar nga serbët dhe po granatohej, dhe e cila ishte qytezë shumë etnike edhe gjatë luftës, ishin serbët, kroatët, dhe kjo qytezë ishte Bihać, serbët, kroatët dhe, dhe boshnjakët, boshnjakët ishin shumicë. Dhe ata thanë, "Po, po, por Sarajeva po qëllohet me plumba". Unë iu thashë, "Po, por keni një njeri këtu". "Po, por fillo me Sarajevën". Por kjo është sekondare... kështu që, jo në baza ditore, por me raste, gjatë viteve që pasuan, kam mbuluar konfliktin jugosllav, konfliktin boshnjak nga Beogradi, konfliktin kroat dhe boshnjak gjithashtu nga, nga, me raste nga Zagrebi.

Pas Dejtonit, pak pas Dejtonit vozita rreth Bosnjës vetëm me makinën time. Kur u ktheva nga Praga dhe gruaja ime e dërgoi atë tek mekaniku për ta servisuar, ata kishin thënë. "Ku dreqin keni qenë me këtë makinë?" (buzëqeshë) Kisha vozitur nëpër disa vrima të granatave, nëpër gropa, natyrisht makina nuk ishte në gjendjen më të mirë. Por çfarë pashë atje, dhe kam intervistuar njerëzit përgjatë rrugëtimit nga Bihać për në Bijeljina përgjatë Serbisë veriore brenda një jave duke marrë me vete *hitchhikers* [udhëtarë në rrugë]. Kështu që, isha relativisht anonim. Këta njerëz ishin veteranë nga të dy anët, disa prej tyre me paterica, ishin refugjatë, serbë nga Sarajeva të cilët nuk kishin qëllim të jetonin tutje në Sarajevë. Isha në Brčko i cili ishte njëri prej vendeve më të granatuar që kisha vizituar në jetën time. Domethënë, do ta rendisja atë përkrah Vukovarit, Bijeljinës ku kisha intervistuar kryetarin dhe

krerë të tjerë të qytezës të cilët, e dini, “gjalpi nuk do të shkrihej në gojët e tyre”, dhe ata më dhanë shpjegimet më të pafajshme rreth asaj se çfarë kishte ndodhur me popullatën boshnjake aty disa vite më parë, ajo natyrisht që nuk korrespondonte fare me realitetin.

Gjatë konfliktit, kur dëshiroja të shkoja në Beograd nëse, gjatë atij konfliktit në vitin '92, '95, nëse do ta shkruaja Kosovën në aplikimin tim për vizë jugosllave, atëherë nuk do të merrja vizën. Kështu që, e dija që ajo ishte thjesht përtej limiteve të mia dhe nuk dëshiroja të nxitohesha me asgjë sepse regjimi... në vitin '95 regjimi ishte krejtësisht ndryshe nga ai i viteve '80. Dhe pastaj Jugosllavët m'i ndaluan vizat tërësisht. Në vitin '99, kur bombardimet e NATO-s filluan, unë isha në Turqi. Isha duke mbuluar ngjarjet në lindje, në pjesën juglindore të Turqisë afër kufirit sirian dhe eventualisht.... Më vonë në prill arrita të fluturoj nga Italia për në Tiranë ku kalove dhjetë ditë, dy javë duke mbuluar ngjarjet me refugjatët në tërë Shqipërinë nga fabrika e duhanit në Shkodër deri tek stadiumi në Korçë e tek baza ushtarake në Maliq, për të vazhduar në anën perëndimore të liqenit të Ohrit, pastaj për në plazhin e Durrësit dhe kafenë “Drenica” në plazhin e Durrësit ku po rekrutoheshin luftëtarë për brigadën e Atlantikut Verior ose brigadën e Atlantikut apo sidoqoftë, e cila sapo kishte arritur nga Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja me varkë nga Italia dhe kështu me radhë. Kështu që, kisha disa ngjarje interesante për të raportuar dhe po, kishte një pasiguri të konsiderueshme mbi atë se ku po shkonte e gjithë kjo sepse Millosheviçi nuk ishte rrëzuar, bombardimet po vazhdonin ditë pas dite, javë pas jave. Helikopterët sulmues të ushtrisë amerikane ishin të parkuar në pistë në aeroportin e Tiranës dhe nuk dukej se do të përdreshin në të ardhmen e afërt. Moti ishte përgjithësisht i vërenjtur, me shi, pilotët nuk shkonin nën 15.000 pëllëmbë kështuqë shumica e sulmeve u bënë me raketa e jo nga avionët me fluturim të ulët.

Anna Di Lellio: A ishit duke punuar për “Zërin e Amerikës?”

Jolyon Naegle: Atëbotë isha duke punuar për “Radio Evropa e Lirë”. Isha zhvendosur, kisha filluar të punoj për “Radio Evropa e Lirë” në vitin '96 dhe isha i vendosur në redaksi. Kështuqë “VOA” kishte një qëndrim shumë më praktik, duke i vendosur reporterët në skenë, kudo. Nëse mund të futeshe, e dini, i vetmi rregull ishte, përpos të të qenit objektiv e të tjerë, e të tjerë, ishte, të mos shkojmë prapa kryetarit të shtetit dhe të provojmë të intervistojmë dikë të lartë pa leje dhe të mos përdorim pjesë të ndonjë himni kombëtar, ose të tërin ose...këto ishin rregulla shumë të thjeshta për t'u kujtuar, kryefjalë, folje, kallëzues, 13 vargje për një minutë e të tjerë. Këto rregulla ishin të lehta. “Radio Evropa e Lirë” ishte pak më e komplikuar dhe më pak qejf, kishte shumë më pak liri dhe më shumë ndalesa, duhej qëndruar ulur në redaksi gjithë kohës, vetëm nëse dëshiroje para për një udhëtim ishte proces tepër i komplikuar, ata prisnin nga ti që të kryeje gjithë raportimin përmes telefonit dhe kjo gjë ishte frustruese.

Por, po, menjëherë pas, pas nënshkrimit të Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës më 9 qershor, 1999, atëherë “VOA” filloi të futej brenda dhe gjithmonë kishin dikë këtu nga redaksia qendrore, dhe shumë shpejt e themeluan një zyre në Prishtinë për Shërbimin Jugor Sllav pjesë e të cilit ishte edhe njësi i Kosovës. Dhe aty u bashkova edhe unë, ishte radha ime në fund të gushtit, dhe

kisha bërë një vijë të drejtë nëpër Junik ku pashë se shumica e kullave ishin rrënuar. E kisha pyetur një koleg i cili kishte qenë në Junik disa muaj më parë nëse kullat ishin ende aty dhe përgjigjja e tij ishte, “Çfarë është kulla?” (buzëqeshë) Sepse Juniku ishte natyrisht i njohur edhe për diçka tjetër, jo vetëm për kulla, fakti që ishte qendër e rezistencës siç kishte qenë përgjatë rebelimit të Kaçakëve në vitin 19...në të 1920-tat e hershme. Shkova atje dhe u takova me disa fshatarë të cilët ishin bujarë përkundër situatës apo humbjeve të tyre në jetë dhe pronë, ata megjithatë ndanë tregimet dhe ushqimet e tyre. Shkova në fshatra të tjera në rajonin e Dukagjinit, ku të gjithë burrat ishin tërhequr apo masakruar. Shkova në Dragash ku njësitë turk të KFOR-it ishte në një furi për të bërë synet të gjithë djemtë të cilët nuk kishin pasur atë mundësi. Nën regjimin e Millosheviçit, bërja synet ishte ndaluar dhe prandaj shumë fëmijë silleshin në Prizren nga autobusët e ushtrisë turke, e dini, të gjithë të veshur për festimin e madh, ata nuk ishin të gjithë pesë vjeç por filluan me të rinjtë dhe e shënjuan rrugën e tyre lartë...

Anna Di Lellio: Sa prej asaj që kishit parë në Bosnjë ndikuan qëndrimin tuaj rreth Kosovës kur erdhët këtu gjatë luftës?

Jolyon Naegele: Epo, nuk kam ardhur këtu gjatë luftës, kam ardhur pas saj.

Anna Di Lellio: Pas luftës.

Jolyon Naegele: Është shumë ndryshe dhe nuk ka ndikuar aq shumë në mua. Ata që ishin në ushtri në KFOR, IFOR dhe SFOR të cilët më pas kishin ardhur në UNMIK thoshin, “Oh e dini, dallimi mes Bosnjës dhe Kosovës ishte katër vjet”. Më falni, kjo është larg realitetit, nuk është qesharake. Po, agresori mund të ketë qenë i njëjti, sidoqoftë aspekti historik, për mua këtu paralelet historike... dhe po, historikisht, dhe kur e shikon hartën është e qartë çfarë përfaqësonte Bosnja për Turqinë Osmane. I shikon ndarjet etnike në Bosnjë. Dhe pastaj e sheh si IFOR dhe SFOR pastaj kanë implementuar një formë të normalizimit në Republikën Srpska dhe në Federatë. Dhe shumë prej këtyre gjërave nuk ishin këtu, brenda një viti pas Dejtonit, të gjithë në Bosnjë kishin tabela të standardizuara dhe askush nuk voziste me tabela të Republika Srpskës. Këtu ende sheh tabela KM për Mitrovicën të lëshuara nga Beogradi dhe qartazi ato makina nuk voziten në jug të Ibrit dhe, për shembull do të shohësh, e dini, tabela PZ për Prizrenin dhe UR për Uroševac [serbisht për Ferizaj], Ferizajin, e të tjerë, e të tjerë.

Nuk kishte diskutim, domethënë ato u implementuan nga IFOR dhe SFOR, puna ishte tek implementimi, Serbia mori mësimin dhe edhe pse kishte shumë njerëz që kishin punuar në Zyrën e Komisionerit të Lartë dhe gjetkë që erdhën këtu duke përfshirë së paku një SRSG,³ e të marrësh pajtueshmërinë e Beogradit mbi tabelat e makinave doli të jetë diçka për të cilën do të duhej më shumë se një dekadë.

³ SRSG, Special Representative to the Secretary General, Përfaqësues i veçantë i Sekretarit të Përgjithshëm.

Anna Di Lellio: Pra, po thoni se Serbia mësoi nga Bosnja...

Jolyon Naegele: Serbia mësoi...

Anna Di Lellio: Për të tërhequr këmbët zvarrë shumë më shumë në Kosovë?

Jolyon Naegele: Epo, po, por gjithashtu sepse, ky do të ishte një thjeshtëzim i tepërt sepse sa për Serbinë, sot e kësaj dite Kosova është Serbi prandaj është një çështje e ndryshme. Me Bosnjën, në gjysmë të konfliktit, ishte e qartë se Beogradi do t'i linte serbët boshnjakë në një anë, dhe ata e dinin këtë gjë. Serbët e Krajinës në Bosnjë ishin, dhe edhe më shumë në Serbi, kishin kapitulluar në gjysmë të luftës, sigurisht në perëndim, ata ishin shumë larg dhe kur iu erdhi në majë të hundës... Dhe ishte e qartë dhe pastaj ndodhi gjatë operacionit *Oluja* [Stuhia], Beogradi i braktisi ata. Këtu u deshën njëmbëdhjetë javë bombardime nga NATO-ja, dhe nuk pati nevojë të zgjaste më shumë, por ndodhi pikërisht për arsye të një oficeri të caktuar francez në NATO-s i cili po e kalonte cakun në Beograd një ditë më parë ose disa orë më parë. Dhe kështu Millosheviçi e dinte se mund të priste shumë gjatë, derisa qiejtë të qartësoheshin dhe NATO të bombardonte kampet serbe në anën jugore të malit Pashtrik afër rrugës kryesore që vinte nga Kukësi, ku serbët kishin pritur se invacioni i NATO-s i udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara do të ndodhte më vonë atë vit. Dhe kështu ata kishin vendosur shumë resurse dhe burra aty, dhe një natë, sipas "The Wall Street Journal" 500 ushtarë shërbyes dhe shumë prej artillerisë ishin shkatëruar dhe Millosheviçi hodhi Traktatin Chernomyrdin Premier rus për paqe shumë shpejt pas asaj, ky është një fund shumë ndryshe nga ai që kemi parë në *Oluja* i cili ishte... forcat kroate të trajnuara nga Shtetet e Bashkuara të cilat më në fund pas katër vjet e gjysmë, pasi i kishin pasur hundët në baltë për katër vite, ata ishin të aftë të rimarrin territorin e tyre dhe ata do të mund t'i mbërrinin edhe portat e Beogradit nëse nuk do t'iu thonin të tërhiqeshin.

Pjesa e Dytë

Anna Di Lellio: Isha thjesht kurioze për përshtypjen tuaj, prindërit tuaj ishin refugjatë...

Jolyon Naegele: Po...

Anna Di Lellio: Dhe praktikisht gjatë këtyre viteve ju keni mbuluar refugjatët, çfarë keni, po mendoj, a keni pasur ndonjë përshtypje personale mbi...

Jolyon Naegele: Natyrisht që po. Sigurisht, varet nga situata. Refugjatët në fabrikën e duhanit në Shkodër jetonin në kushte shumë të varfëra por ishin shumë të disponuar, por nuk kishin një të ardhme të pasigurtë. Refugjatët që i kam takuar anës liqenit të Ohrit në anën shqiptare ishin nga Prishtina, ata ishin krenarë, të dinjitetshëm, të irrituar për atë se si serbët praktikisht kishin ardhur në shtëpitë e tyre, kishin trokitur në dyer dhe kishin thënë, "Na i jipni çelësat e makinës dhe dilni nga këtu për dhjetë minuta". Dhe disa prej tyre ishin më shumë të shqetësuar për makinat, edhe pse kishin një palë çelësa rezervë por nuk ishte...Dhe ata tashmë e kishin refuzuar një kamp ushtarak ku ishin

dërguar në fillim, mesa duket në Maliq, dhe kishin thënë, “Nëse mendoni se do të flemë në beton, ne jemi nga Prishtina, as mos e mendoni një gjë të tillë, na dhuroni diccka dinjitoze”. Kështuqë në fund ata përfunduan në vend të një kampi ushtarak shqiptar, në një kamp grek ose në Kryqin e Kuq Grek dhe fjetën në mes të një fushe, pamje shumë e bukur, ajër i pastër, por ishin në tenda.

Dhe pastaj vinin ata nga Gjakova të cilët i pata takuar në plazhin e Durrësit në një kamp Italian nga Miterkolja apo sidoqë quhet, dhe atyre po iu shërbehej darka. Isha aty në kohën e darkës dhe po rreshtoheshin për të marrë pasta dhe pene e sallatë dhe po ankoheshin, iu thashë, “Cfarë është problemi?” Unë po vdisja urie dhe ata apo ankoheshin, thashë, “Cfarë, çfarë është problemi?” “Ky ushqim...” “Pra, çfarë është problem me të?” “Nuk është, nuk është ushqim i vërtetë”. Dhe mbani mend që këta ishin njerëz nga bjeshkët, nuk ishin nga bregu dhe pastaj një djalë më tha, “Duam ushqim që hahet me lugë”. Dhe pastaj ai tha, “Gullash!” E dini, për ata, ky ishte ushqim lepujsh, sallatë, pastat nuk ishin në rutinën e tyre ditore dhe italianët po bënin më të mirën e mundshme dhe unë do ta kisha ngrënë të gjithën (buzëqeshë) por sidoqoftë...

Ja pra, kjo ishte pak një ide e asaj dhe njeriu mund të ketë simpati apo të thotë, “Iu lutem!” Marrë parasysh realitetin dhe atë që po ndodhë, “Duhet t’iu vijë turp nga vetja!” Por unë nuk thashë asgjë. Cfarë m’u duk më interesant se gjithçka tjetër, të gjitha këto ishin përvoja shumë interesante. Por ajo që më ka gllabëruar më së shumti deri më tani, çfarë më ndjek sot e asaj dite është kur isha në qafmalin e Morinës në Vërmicë në anën shqiptare, por goxha larg nga kufiri dhe e shihja masën e njerzve që vinin.

Tani, atë mëngjes, dhe kjo ishte, duhet të ketë qenë diku rreth 2 maj ose 1 maj, 30 prill, diku aty, i vitit ‘99. Kisha dalë herët në mëngjes dhe vendi ishte i zbrazët, një oficer shqiptar ishte mbështetur në mbajtëset e kufirit disi duke shikuar nga Kosova dhe natyrisht, nuk kishte trafik nga asnjëra anë, natyrisht unë isha aty me një shofer dhe një interpretues dhe thashë, “Pra, ku janë të gjithë?” Ai tha, “A e sheh tymin atje lartë?” {shpjegon me duar} thashë, “Po,” ai tha, “Ai ishte kamp ushtarak i ushtrisë serbe deri para dy orësh por një grup luftëtarësh amerikanë e asgjësuan”. Thashë, “Pra, supozoj se njerëzit tuaj tani po fshihen?” Ai tha, “Po, të gjithë janë poshtë në bunker”. Dhe unë thashë, “As ne nuk duhet të jemi këtu nën këto rrethana, me të vërtetë nuk duhet të jemi këtu sepse mund të ketë zjarr hakmarrje në secilën minutë”. Dhe kështu u kthyem në Kukës ku na tha, “Shikoni, ata nuk, serbët nuk e lënë askënd të dalë deri pas orës 10:00 në mëngjes, kështuqë kthehuni në orën 11:00 dhe do t’i shihni skenat,” dhe natyrisht ashtu ndodhi, siç u pa edhe në “BBC”, “SKY” apo “CNN”. Një linjë makinash deri në Prizren duke gjarpëruar dëri në kufi dhe njerëzit në makina, makinat ishin të mbushura plot me njerëz, deri në maksimum saqë njerëzit brenda tyre shtypeshin dhe këta njerëz ishin tërësisht të traumatizuar, kjo ishte e qartë që në shikim të parë. Ishte një grua më e moshuar nga Kryqi i Kuq Zviceran e veshur me uniformë ajo që iu afrua secilës makinë dhe e godiste në krahë secilin person

brenda makinës dhe në shqip i siguronte se ishin të sigurtë, se nuk ishin më në Serbi, Jugosllavi, se ishin në Shqipëri dhe ishin të sigurtë.

Disa njerëz kaluan kufirin në këmbë, ata që nuk kishin makina dhe ishin lejuar të vijnë me autobus vetëm deri në Prizren apo edhe më larg se Prizreni, kështuqë ata erdhën në këmbë, kryesisht gra. Ato ishin gjithashtu të traumatizuara, kishin parë copa të trupave, njerëz të vdekur, jashtë, anës rrugës ku policia serbe kishte marrë njerëzit, ushtarët, paramilitarët kishin nxjerrë njerëzit nga makinat, autobusët, burrat e rinj, dhe thjesht i kishin qëlluar ata për vdekje. Unë, dhe ata, këta njerëz pastaj erdhën në anën tjetër dhe disi filluan, disi prisnin që të afërmit e tyre që kishin ikur tashmë nga Kosova do të ishin duke i pritur atje.

Ishin të paorientuar, më kujtohen vetëm disa gra duke i lënë çantat e tyre në mes të fushës dhe duke shikuar përreth e duke mos ditur në të vërtetë ku të shkojnë, çfarë do të vinte më pas, nuk kishte një qendër pritje, asgjë. Të tjetër kishin kaluar kufirin me traktor, një tjetër më tha se kishte menduar se do të mund të qëndronte në Gjakovë me familjen por atë mëngjes, në orën 3:00 të mëngjesit forcat serbe kishin shkuar në shtëpinë afër të tyre dhe kishin nxjerrë komshiun në oborr ku e kishin qëlluar dhe ai tha, “Kaq, nuk mund të duroj më shumë,” kishte paketuar çantat, ishin futur në makinë dhe kishin ikur brenda minutash.

Anna Di Lellio: Pse, kjo është më shumë, e dini, pse ka mbetur kjo më shumë në kujtesën tuaj sesa...ju thatë se keni folur me shumë refugjatë...

Jolyon Naegele: Në rregull, jo, jo sepse njerëzit ishin ende në një gjendje të traumës së plotë në atë kohë. Nëse intervistojë dikë disa javë pasi kishin ikur, ata do të ishin më të qetë, do t'i kishin vendosur gjërat në perspektivë dhe do të ishin më të relaksuar. Kur flet me dikë që vetëm para disa orësh ka parë një njeri tek vritej mbi baza etnike, moshe ose gjinie dhe ata thjesht e rikujtojnë këtë për ty si njeriu i parë të cilit po ia tregojnë këtë tregim, natyrisht kjo gjë të gllabëron në një mënyrë krejt tjetër. Kështuqë po, është, është diçka që më ndjek le të themi, nuk është diçka që do ta harroj ndonjëherë. Ishte, ishte një ide e traumës nëpër të cilën ata po kalonin. Dhe kur ua tregoj këtë rrëfim kosovarëve, i prek edhe ata në nerv fakti që unë e kuptoj, që unë e di, që kam një ide mbi atë që shumica prej tyre kanë përjetuar, të asaj nëpër të cilën kanë kaluar...

Anna Di Lellio: Kur keni shkuar në Kosovë pas luftës?

Jolyon Naegele: Në verë, në gusht kur gjërat ishin relativisht të qeta. Shumë biznese që ishin djegur gjatë konfliktit tashmë ishin rihapur, ato ishin, të tjera ishin në process të rihapjes, duke u ngjyrosur, duke vendosur xhama të rinj, tabela të reja, dritare të reja e të tjerë. Nuk mund të shkoje në Gërmi e cila ishte përtej kufinjve të tankeve britanike, dhe personeli britanik ishte i vendosur afër Universitetit Amerikan, pra njerëzit nuk mund të vozisnin më tutje se aq, rruga në mes Pejës dhe Prizrenit ishte në gjendje të tmerrshme, qartazi e dëmtuar nga një kombinim i sulmeve ajrore dhe trafikut të tankeve të rënda, në një gjendje me të vërtetë, me të vërtetë të tmerrshme. Serbët nga Rahoveci e bllokoi

rrugën nga Malisheva në Gjakovë, e cila më duket se ishte rruga më e shkurtër, ne e mendonim si rrugën më të shkurtër për të arritur në Gjakovë. Malisheva ishte komplet e shkretuar, Vitia ishte, e dini, komplet e djegur, Klina ishte komplet e djegur.

Anna Di Lellio: Ku keni qëndruar?

Jolyon Naegele: Kam qëndruar aty ku kanë qëndruar të gjithë, në “Grand Hotel”, aty ku kisha qëndruar edhe në fund të të ‘80-tave, në hotelin që kishte ripunësuar gjithë ish stafin e tij nga të ‘80-tat, të cilët ishin larguar në vitin ‘89- ‘90, kështuqë ato ishin fytyra të njohura. Nuk qëndrova në “Hotel Dukagjini” i cili më parë ishte “Hotel Metohia” sepse në atë kohë ajo ishte baza e kontigjentit italian të KFOR-it. Por shkova aty për vizitë, fola me një numër oficerësh.

Intervistova, intervistat më interesante të asaj kohe i kam bërë në Pejë. Kam intervistuar familjen ku babai kishte qenë apo ishte dejtore i një shkolle për të verbër dhe kur bombardimet e NATO-s kishin filluar, nëse nuk gabohem, ishte në mes të muajit të Ramazanit apo ditës së Bajramit apo diçka e tillë. Nuk e di tregimin e saktë, por praktikisht shumë prej familjeve nuk kishin mundësi të vinin për t’i marrë fëmijët e tyre. Ata ishin larguar dhe ai kishte mbetur brenda me shumë fëmijë, me goxha shumë fëmijë të cilët duhet t’i ushqente për aq sa do zgjasnin bombardimet, që nënkupton se atij i duhej të dilte çdo ditë, dhe praktikisht të plaçkiste nëpër Pejë, për të gjetur ushqim për fëmijët dhe pastaj në mbrëmje, policia serbe, paramilitarët parkonin mjetet e tyre transportuese në oborrin e shkollës duke e ditur se ishte një vend i sigurtë në kuptimin që nuk do të bombardohej. Ai më dha një intervistë të mrekullueshme dhe ishte njeri fasciuës, nuk e di nëse është ende gjallë por ia vlen të kërkohet. Vajza e tij me bashkëshortin e saj dhe fëmijën, mendoj se kanë ecur në marshin e parë për në Mal të Zi dhe pastaj gjatë bombardimeve kishin qenë në Ulqin. Por, ajo më tregoi mua, u ulëm në banesën e tyre, ndërtesë moderne e lartë në periferi të Pejës, dhe ajo më tha, “Për mua është mrekulli që mund të ulemi këtu sot. Në gusht të vitit ‘99, kur ika nga këtu nuk e kisha idenë nëse do të mund ta shihja Kosovën përsëri, nëse ndonjëherë në jetë do të kishim mundësi të ktheheshim”. Dhe ajo ishte më e re se unë por...

Anna Di Lellio: Ajo ishte një verë e vështirë dhe serbët tashmë ose po përjashtoheshin ose e dini, në të shumtën e rasteve ata ikën për arsye se situata ishte shumë e tensionuar, a keni tregime rreth...

Jolyon Naegele: Po...

Anna Di Lellio: Ikjes së serbëve?

Jolyon Naegele: Shumica e serbëve kishin ikur, çfarë kam bërë unë është kam shëtitur dhe parë fshatra në flakë të cilët po digjeshin shtëpi më shtëpi në mënyrë sistematike. Dhe i kam intervistuar serbët se ku i kishin dërguar gratë dhe fëmijët e tyre, dhe praktikisht ata ishin aty për të mbrojtur pronat e tyre dhe kjo ka ndodhur në afërsi të Istogut, ku fillimisht kam shkuar tek kampi i KFOR-it spanjoll ku kam intervistuar zyrtarët he pastaj kam shkur në disa prej këtyre fshatrave, dhe makinat e

zjarrit të cilat po ruheshin, u shfaqën dhe ata ndezën zjarr, ato ishin zjarre të vogla dhe në vete por ishte një operacion sistematik nga tepricat e UÇK apo të tjerëve që thjesht dëshironin t'i hiqnin qafe ata. Dhe kështu që, po, kam mbuluar edhe atë aspekt në veçanti, dhe kjo gjë ka vazhduar edhe kur kam shkuar në Kosovë në vitin 2003. Më kujtohet, isha ulur në një kafe në Prizren dhe nën kala një shtëpi tjetër digjej dhe njerëzit thjesht e shikonin nga poshtë, ndoshta dy apo tre shtëpi, njerëzit thjesht e shikonin dhe vazhdonin me pijet e tyre, kjo ishte gjithashtu shumë penguese, po, dhe kam intervistuar baba Ssavën në një apo dy raste dhe unë qartazi nuk isha shqiptaro-centrik, çfarë isha unë ishte ajo që unë raportoja.

Anna Di Lellio: Thatë se keni ardhur në vitin 2003, apo jo, kishte një ngritje të madhe...

Jolyon Naegele: Po, u zhvendosa këtu...

Anna Di Lellio: Po mendoj, ju jeni i interesuar në marrëdhënie ndërkombëtare, i interesuar në Evropë, ju punoni si gazetar, duket si një kohë e përshtatshme për të qenë gazetar dhe është diçka që e keni bërë atëbotë, por pastaj në vitin 2000, një ndryshim ka ndodhur në Evropë...

Jolyon Naegele: Saktë, po...

Anna Di Lellio: Si keni, si keni vendosur dhe nga kush, si jeni punësuar?

Jolyon Naegele: Në rregull, kam qenë kurioz dhe i interesuar për të punuar për Kombet e Bashkuara që kur kam qenë në studime post-diplomike. Kur ishim në vitin e tretë, na dërguan në Kombet e Bashkuara ku patëm rastin t'i shohim flamujt e vendosur jashtë, për mua kjo ishte natyrale përpos përpos kësaj, kur fillova ta shikoja pas studimeve, nuk kisha asnjë përvojë, gjithçka kisha ishte edukimi dhe gjuhët që njihja ishin qartazi gjuhët për të cilat ata kishin nevojë dhe kështu u vendos. Në vitet e '90-ta Kombet e Bashkuara bënë jo më pak se një puën të mrekullueshme në Bosnjë dhe Kroaci dhe si reporter pashë sa të përbuzur dhe sat ë dobët ishin në zbatimin e mandatit të tyre, njeriu mund ta vërente sa i dobët ishte edhe mandati i tyre këtu, apo jo? Po mendoj nuk është se kam pasur ndonjë ndjenjë të fuqishme që po, kjo është diçka të cilën unë duhet ta bëj, të punoj për UNMIK-un. Unë isha më shumë i shokuar nga numri i mjeteve transportuese të Kombeve të Bashkuara në rrugë, sidomos në *rush hour*, praktikisht Kombet e Bashkuara po financonin lëvizjen e njerëzve brenda Prishtinës.

Anna Di Lellio: Më lejoni t'iu ndërpres...

Jolyon Naegele: Po, viti '99...

Anna Di Lellio: Pra, keni pasur një pikëpamje ideale rreth Kombeve të Bashkuara, po mendoj keni dashur të prisni derisa realiteti...

Jolyon Naegele: Unë nuk isha naiv pasi që si student në studimet e post-diplomike kisha studiuar këshillim të kombeve të bashkuara dhe kishim diskutuar me profesorët rreth Kombeve të Bashkuara

në seminare të ndryshme, dhe në vitin 1978 unë tashmë kisha ardhur në përfundim se zgjidhja të cilën e kishim mësuar ne ishte për të djegur Sekretaritin dhe për të filluar nga fillimi. Në fakt, e kam thënë edhe në klasë që kjo nuk ishte diçka e re për mua, kisha lexuar mjaft për atë temë si person i jashtëm.

Anna Di Lellio: Çfarë ka qenë diçka pozitive që iu ka tërhequr, e kuptojmë që e keni kuptuar realitetin dhe të metat e Kombeve të Bashkuara por çfarë ishte...

Jolyon Naegle: Diçka pozitive që më ka tërhequr ka qenë si vijon, në Kosovë kjo ishte hera e parë që Kombet e Bashkuara në fakt do të administrojnë një territor në baza të përkohshme, ishte Administrimi i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Emri nuk ishte ndërruar kurrë zyrtarisht dhe ideja ishte, kuptimi ishte, nëse e lexon me kujdes rezolutën 1244, që ky ishte operacion i përkohshëm deri në një kohë të tillë kur komuniteti ndërkombëtar do të pajtohej se si do të shkohej tutje në lidhje me pavarësinë e Kosovës pasi që nuk dukej e preferueshme që Kosovës t'i jipej pavarësia pa kurrfarë mudi menjëherë pas konfliktit. Kjo nuk ishte luftë për pavarësi, siç mund ta përshkruajnë disa, po, ishte një moslogaritje, njerëzit mund të pajtohen se kjo ishte një keqlogaritje nga Clinton dhe të tjerët, sidomos Blair, çfarë po mendonin ata në të vërtetë dhe ku po shkonte e gjithë kjo, a dëshironin të kompenzonin faktin që nuk kishin qenë mjaft të ashpër me Millosheviçin dhe e kishin sforcuar Kosovën në tavolinën e bisedimeve në Dejton në vitin '95, epo nëse do të kishin qenë të suksesshëm në atë, kush e di, ndoshta tani do të ishim të ulur në Serbi e jo në Kosovë.

Po, pra dija diçka rreth Kosovës, isha i fascinuar me të, fakti që Kombet e Bashkuara po e udhëhiqnin vendin tashmë, nuk e di, nuk e dija asgjë për administrimin civil por gjatë kohës sa isha këtu në një vizitë raportuese në vitin 2002, në kohën kur SRSG ishte Mikhail Stenier, të cilin e kisha njohur më parë dhe të cilin dëshiroja ta intervistoja dhe po kërkoja një numër kontakti, dhe pastaj në faqen e UNMIK-ut e vërejtja se kishin një faqe punësimi dhe aty ishte një thirrje për një analist politik në Pejë. Thashë se ishte e shkruajtur që unë të zhvendosesha në Pejë, tashmë kisha vijuar dy kurse në shqip, mundesha disi të kuptohesha në serbisht dhe kisha shkuar në një shkollë verore shqipe në Tiranë dhe në Prishtinë në dy vitet paraprake, kështu që kjo dukej e qëndisur për mua, thashë pse jo.

Kështu që bëra një intervistë me Steiner dhe i tregova rreth kësaj e ai më tha, "Më trego thirrjen," unë ia tregova dhe tha, "Pse do të doje të ishe në Pejë?" Unë thashë, "Epo, Prishtina është si një flluskë anglisht-folëse tashmë, pse do të doja të isha këtu? Jam kurioz për kulturën por dua të shoh si zhvillohet ky vend dhe nëse do të jem në një ambient anglisht-folës, atëherë do të jem më i izoluar nga realiteti," Ai tha, "Epo, nuk më duhesh për në Pejë nëse do të punosh si këshilltar imi dhe zyrën për marrëdhënie politike, jo këshilltar imi por ti, ti dëshiron të punosh brenda zyrës së marrëdhënieve politike, atëherë ajo do të jetë në Prishtinë, kështu që vendos". Unë thashë, "Në rregull, në rregull, do ta pranoj Prishtinën". Kështu që unë isha pjesë e një kompromisi. Nëse do të insistoja të shkoja në Pejë, do të mund të pranohesha por do të isha jashtë saj pas vetëm një viti dhe ndoshta do të më duhej të punoj për radion "Për Evropën" apo kushedi. Cfarë m'u duk fascinuese dhe pse qëndrova nuk ishte vetëm sepse më pëlqen Kosova, më pëlqen të ngjitem në maje, më pëlqen vendi, më pëlqen gjithçka përpos asaj që prodhon Obiliqi dhe ajri i keq dhe më në fund isha brenda në kuptimin e marrjes së

vendimeve, nuk isha më gazetari spekulues që mbahej prapa ose jashtë në anën tjetër të dyerve të mbyllura duke e pyetur veten se çfarë vendimesh po merreshin dhe pse nuk tregoheshin rrëfimet e plota.

Tashmë isha brenda, aty ku merreshin vendimet dhe për herë të parë në jetën time kisha mundësinë të shoh se si po merreshin ato vendime dhe po merrja pjesë në atë process, e kjo ishte diçka që më tërhoqi, më përthithi, nuk mund të largohesha nga ajo për një vit apo dy sepse aty vlerësohesha për njohuritë e mia mbi fushën, shoqërinë, për shkak të mungesës së ndonjë kohe fillimi, erdha këtu ku mund të takohesha me ta dhe të filloja raportimin, punën, fillova të shkruaj që nga dita e parë meqë l kisha kontaktet dhe bazuar në ato kontakte mund të filloja punë menjëherë. Politikisht sikur, sikur Bosnja...Serbia dhe Kroacia, ishte dinamike, ndryshime ndodhnin edhe nëse largohesha qoftë për dy javë dhe duhej të filloje pothuajse nga fillimi në mënyrë që të zësh hapin dhe ishte një supozim në retrospektivë, një supozim nga amerikanët ndër amerikanë, gjermanë dhe francezë e italianë se po, në 2006-tën apo më së voni 2007-tën, Kosova do të ishte e pavarur dhe UNMIK-u do të largohet e pastaj kushedi, do të vinte një mision tjetër, dhe në fakt në 2005-tën unë mora kërkesën e parë për të shkuar në një mision tjetër në Sudan, ndërkohë që isha me pushime në Norvegji, shefi im më tha, “Vetëm thuaju se na duhesh këtu dhe thuaj falemnderit, por jo”. Ata u kthyen nga Sudani të paktën njëherë, nga Darfur dhe mua më thanë se iu duhesh këtu dhe pastaj mendova se isha duke shkuar në Afganistan dhe e gjithë kjo arriti deri te zëvendës-sekretari i përgjithshëm i misionit paqeruajtës i cili tha, “Rri aty ku je dhe kur të vijë koha do të shikojmë,” dhe pastaj unë u pensionova pas 14 vjetësh. Kishte shumë misione në të cilat do të isha i interesuar të punoja dhe aplikova herë pas here, sidoqoftë, sistemi brenda Kombeve të Bashkuara, departamentit të marrëdhënieve paqeruajtëse dhe shërbimi i personelit në terren është jofunksional kur flitet për mobilitet. Ata janë duke prezantuar një sistem të ri tani që...Pyes se kur do të jetë më funksional sesa që ka qenë, gjithçka që ka ekzistuar në të kaluarën por nuk mund të pranohesh në asnjë pozitë pune pa njohur dikë. Kurrë nuk jam pranuar në asnjë pozitë pune pa njohur dikë, e këtu po flas edhe për UNMIK-un, dhe kjo është fatkeqësisht mënyra se si gjërat funksionojnë në Kombet e Bashkuara e jo vetëm.

Pjesa e Tretë

Anna Di Lellio: Cila ka qenë koha më e vështirë për ju në këto 14 vjet, ju keni filluar në vitin 2003?

Jolyon Naegele: Pra, marsi i vitit 2004, kjo ishte koha më e pakëndshme. Kjo zgjati dy ditë e gjysmë sepse kishte gjuajtje me armë në rrugë, grabitje apartamentesh, apartamentesh të stafit të UNMIK-ut, vrasje njerëzish. Trazirat e marsit të vitit 2004 ishin shqetësuese, shumë shqetësuese, hmm, nga perspektiva e UNMIK-ut, gjithçka për të cilën kishin punuar ata për vite, standardet para statusit për t'i bërë njerëzit të kuptojnë atë që duhej të bënin në mënyrë që Kosova ta impresiononte komunitetin ndërkombëtar mjaftueshëm për të thënë po, le të ecim përpara... dhe të zgjidhim statusin e Kosovës, e gjithë ajo shkoi dëm me një seri incidentesh të manipulimit të opinionit publik dhe kryesisht

nëpërmes RTK-së por gjithashtu edhe përmes mediave të shkruara. Dhe, dhe, dhe, dështimi i KFOR-it për arsye të, si quhen ato, paradigma nacionale, sidoqoftë, kontigjentet vendosën rregullat e tyre për angazhim dhe disa performuan shumë mirë ndërkohë që disa kontigjente u dëshmuar të jenë komplet joadekuate, shumë njerëz u lënduan e disa të tjerë vdiqën, ne kemi tendencë të harrojmë se sa njerëz u vranë dhe në çfarë rrethanash.

Ne gjithashtu kemi tendenca të harrojmë se çfarë solli deri tek ato vrasje. Ato nuk kanë ndodhur papritmas, nga asgjë, dhe nuk nënkuptoj që incidentet në 48 orët e mëparshme, por gjithashtu disponimi i përgjithshëm publik për të cilin edhe UNMIK-u bart një pjesë të fajit, por gjithashtu, grupi i kontaktit meriton të fajësohet për shkak që nuk ka qenë i hapur dhe që e kishte mbajtur çështjen e statusit të ardhshëm të Kosovës në tavolinë që nga shtatori i vitit 2003. Por asgjë nuk kishte rrjedhur për arsye se SORG në kohën kur bisedimet po mbaheshin në New York dhe i cili morri pjesë në pjesën e parë të bisedimeve e i cili ishte në dialog u ngrit kur artikulli i dytë në agjendë e që ishte statusi i Kosovës u diskutua dhe tha se ajo çështje nuk ishte pjesë e mandatit të tij. Kjo ishte e pasaktë. Sipas meje ai duhej të rilexonte 1244, por ai, supozoj se njerëzit në DPKO i kanë thënë të mos merrte pjesë në atë pjesë të takimit, ai veprim ishte i pamundur. Kështu që, ajo iu kalua grupeve të kontaktit dhe ata nuk lanë asgjë të rridhte prandaj njerëzit kishin përshtypjen që asgjë nuk po ndodhte, asgjë nuk po ecte përpara. Në mars, dyshoj se nuk ishte gjithçka krejt spontane. Ekzistojnë ende shumë pyetje pa përgjigje, kush qëndron prapa vrasjes së djalit serb 15 vjeçar në Çagllavicë, i cili ishte qëlluar nga një makinë në lëvizje. Ajo ishte, pastaj ajo preku postblloqet serbe në rrugën kryesore në mes Prishtinës dhe Ferizajit dhe gjithashtu në rrugën kryesore përmes Graçanicës në Gjilan.

Mbrëmjen e ditës tjetër, më duket se ishte ditën tjetër, pati mbytje të fëmijëve në lum në Çabra, në Ibër. Çfarë ndodhi me të vërtetë aty? Kush udhëzoi masën matanë urës në anën veriore të Mitrovicës në një breshëri zjarri, kishte shumë çmenduri, dhe kishte shumë kalkulime. Nëse shikoni në numrin e madh të përplasjeve, të përplasjeve serioze dhe djegien e shtëpive që kishte ndodhur në pjesë të veçanta të lagjeve në Çagllavicë dhe Fushë Kosovë, *Kosovo Polje*, lagje serbe, ekzistonin lagje serbe atëbotë dhe pastaj brenda një viti ose dy, ato u blenë për gjoja zhvillim nga spekulatorë shqiptarë, përfshirë këtu politikanë.

Duke i transformuar këto lagje në diçka në ndërtesa të larta dhe prona komerciale, siç është rasti i Fushë Kosovës, *Kosovo Polje* apo zhvillime sub-urbane dhe dyqane komerciale siç është rasti i Çagllavicës. Kjo, kjo ngjyrosë një pikturë goxha të ndotur, por kjo, por kjo nuk ishte diçka spontane, kjo ndodhi për të krijuar spekulimet se serbët po përjashtoheshin, në mënyrë që të krijohet një situatë më minimale për të blerë prona dhe për të bërë para të shpejta siç ishte për shembull disa nga këto prona ishin ndërtuar në atë kohë për autostradë, por ndërkohë kishte politikanë dhe të tjerë të cilët kishin blerë tokë në mënyrë që pastaj të ishin të aftë ta shisnin atë për një përfitim domethënës, ndonjë blerje të madhe nga shteti në kohën kur autostrada për Shkup po ndërtohej. Kështu që, në atë aspekt mendoj se aspekti i frikës... natyrisht ti je duke ecur jashtë në rrugë dhe ka gjuajtje me armë dhe ti nuk mund të shkosh në shtëpi sepse është shumë e rrezikshme dhe duhet të gjesh një vend zëvendësues për të kaluar natën. Një gjë e tillë nuk është fare e këndshme as qesharake, megjithatë kjo është diçka

e vogël krahasuar me njerëzit që kishin humbur jetët e të tjerë që kishin humbur shtëpitë për shkak të interesave mashtruese të njerëzve të caktuar, të individëve të caktuar.

Anna Di Lellio: Po, në 2004 më shumë pati shqiptarë të vdekur sesa serbë?

Jolyon Naegle: Po, po, por shiko, numri total i të vrarëve ishte 21 njerëz, dy prej të cilëve, dy prej të cilëve kishin vdekur disa ditë më vonë, ata ishin një çift të moshuarish serb, shtëpia e të cilëve ishte djegur ashpërsisht, pastaj ata vdiqën në spital më vonë, kjo ngrit një pyetje tek e cila mund të kthehem më vonë. Po, më shumë shqiptarë vdiqën, por pse? Nën çfarë rrethanash? Ata u dërguan në anën tjetër të urës në një breshëri plumbash, kush i dërgoi ata në Mitrovicën veriore nga Mitrovica jugore, kush dëshiron diçka të tillë? Pse, pse ata njerëz nuk u sollën kurrë para drejtësisë? Askush nuk i ngrit këto pyetje, ky është, ky është, ky është problem im. Po, ata nejrëz vdiqën por çfarë po mendonin teksa kalonin në veri? A supozuan se kujdestarët e urës të cilët kishin shkaktuar kaq shumë telashe që nga viti 1999 thjesht do t'i shikonin dhe do t'i lejonin të kalojnë? Më falni, dhe ai, ai djali në Novosellë që ishte qëlluar nga një police amerikane e cila e pa atë duke ecur në Novosellë me pistoletën e tij dhe i kërkoi ta ulte armën, me sa duket në anglisht, me sa duket ai nuk e kishte kuptuar, por ajo ishte në uniformë dhe ai e kishte injoruar e ajo e qëlloi, epo ajo ishte police amerikane. Domethënë, po, më shumë shqiptarë vdiqën, sa për serbët që vdiqën nuk e di sa prej tyre diqën me armë në duart e tyre, nuk e di. Atëherë, numri total i vdekjeve ishte 21, numri total i pronave të kishave tridhjetë e disa, 31, e gjitha është shumë serioze, numri i të lënduarve është shumë më i madh, kurrë nuk flasim për oficerët e policisë së Kosovës, oficerët e policisë së UNMIK-it, as ushtarët e KFOR-it të cilët u lënduan, dhe të gjithë këta numra të kombinuar arrijnë në 200. Dhe pastaj kur e ngritë këtë temë me akademikët apo politikanët e Kosovës ata thonë, "Oh, kurrë nuk kam dëgjuar për diçka të tillë më parë". Kjo është publike, është në internet, është në raportin e UNMIK-it në Këshillin e Sigurimit nga, në fund të prillit, besoj në vitin 2004, mbi dhunën, çdo gjë është aty, por ne fokusohemi vetëm në, "Më shumë ka shqiptarë të vdekur se sa serbë," kjo me të vërtetë e redukton atë, e kjo nuk është poenta. Poenta është se 21 njerëz vdiqën pa arsye. Sa miliona janë fituar, çfarë lloj përfitimesh kanë ardhur nga ky incident, këto dy ditë e gjysmë të dhunës së pakuptimtë.

Anna Di Lellio: Po, por ju, ju keni ngritur një urë. Kurrë nuk ka pasur forca të ligjit dhe rendit në Mitrovicën e veriut. Rreth 1600 shqiptarëve iu desh të largoheshin nga shtëpitë e tyre, kjo ka ndodhur para kohës suaj, diku në vitin 2000 kur ata ishin... kundër shqiptarëve. Kurrë nuk ka pasur qasje, kjo duhet të ketë qënë shumë frustruese mendoj për të gjithë, fakti se atje ekziston kjo ndarje, dhe veriu është komplet i spastruar etnikisht nga lufta, pothuajse i spastruar etnikisht, duhet të ketë qënë frustruese edhe për UNMIK-un. Si, si ia keni dalë me veriun?

Jolyon Naegle: Eh po, ata kanë një zyrë në veri dhe zyra në të gjitha komunat, në Leposaviç, Zubinpotok, Zvečan dhe poashtu edhe në Mitrovicë të veriut. Dhe ata ishin, UNMIK-u ishte i përgojuar nga serbët në veri të Kosovës deri në kohën kur Kosova shpalli pavarësinë, pikë kjo në të cilën ata bënë një kthesë 180 shkallëshe dhe mblodhën veten e vendosën flamurin e Bashkimit Evropian krahas atij

serb dhe pastaj ne u bëmë mbrojtësit e tyre më të mëdhenj, sipas pikëpamjes së tyre, por deri atëherë nuk kishte dashuri në mes nesh, ishte po aq keq sa marrëdhënia e tyre e mëvonshme me EULEX-in.

Anna Di Lellio: Ciladoqoftë, ku, cili ishte moment i vështirë, cili ishte momenti më frustrues apo çfarë ishte më së shumti frustruese?

Jolyon Naegele: Oh, shumë prej tyre.

Anna Di Lellio: Veprimi më frustrues për juve si zyrtar i Kombeve të Bashkuara në këto 14 vjet?

Jolyon Naegele: Do të thoja se që nga viti 2011-2012, ky mision ka pushuar së ekzistuari. Rezoluta 1244 është përmbushur. Serbia është preferueshëm e aftë të ulet në tryezë me Kosovën pa prezencën e domosdoshme të një përfaqësuesi nga Kombet e Bashkuara. Të gjithë artikujt e shprehur në rezolutën 1244 rreth detyrave të UNMIK-ut janë përmbushur. Çfarë po bëjmë këtu? Pse dëgjojmë kaq shumë tregime kontradiktore se në të gjitha seancat e Këshillit të Sigurimit me rusët dhe serbët e ndoshta edhe me shtete të tjera se ata janë bindur të flasin, duke e përshkruar situatën këtu sikur nuk kanë fare lidhje me realitetin. Kjo është frustruese, fakti që mbase meqë rezoluta 1244 ka përfunduar, UNMIK-u mund të jetë këtu për shumë dekada sepse nuk ka strategji përfundimtare, ka pasur një supozim të pavërtetë, por ata nuk kanë dalë, ishin shumë të shqetësuar, amerikanët ishin shumë të shqetësuar në vitin 1999 se nëse do të lejonin Këshillin të rinovohet në baza vjetore, në një pikë Millosheviçi do t'i bindte rusët për dikë tjetër dhe gjithçka do të merrte fund, pra ne jemi këtu për të qëndruar, ose ata janë, unë jo.

Anna Di Lellio: Cili është momenti më qesharak, gjëja më qesharake, momenti ose gjëja më qesharake që keni bërë gjatë përvojës këtu, duhet të ketë diçka...

Jolyon Naegele: Kjo është pyetje që nuk e prisja, qejf, qesharake?

Anna Di Lellio: Sureale...

Jolyon Naegele: Po, sureale, vizita e Ban Ki-Moon ishte sureale. Më duket se hiç më larg se dje pamë se si mediat mbuluan fluturimin direkt të Donald Trumpit për në Arabinë Suaidte e pastaj në Izrael, eh po kjo nuk dallon shumë me atë kur Ban Ki-Moon fluturoi direkt nga Beogradi për në Prishtinë, por për arsye të motit anipse nuk kishte stuhi, aeroplani i tij u drejtua për në Shkup. Pastaj, ai pati një udhëtim në vorbull ere për disa orë dhe njeriu ynë i protokollit ishte siguruar që gjithçka të shkonte saktë dhe në linjë me statusin e neutralitetit për vizitën e tij me presidenten Jahjaga në aeroportin e Prishtinës. Menjëherë pas arritjes së tij, u mbyll dhoma ashtu që askush të mos mund të ndërhynte dhe kështu Ban Ki-Moon u soll në dhomë dhe ndërkohë dikush kishte ndërhyrë dhe ai u ngrit përballë portretit të Jashar, Adem Jasharit në një anë dhe një riprodhimi të dekorimit të pavarësisë në anën tjetër dhe u fotografua, pa qenë i vetëdijshëm për atë që po ndodhte prapa tij dhe njeriu i protokollit normalisht, nuk shihej askund. Dhe gjithçka që mund të mendoja ishin të gjithë kuajtë e mbretit dhe të gjithë burrat e mbretit, domethënë, ky është rasti i "Humpty Dumpty", pa marrë prasysh sa shumë përgatitesh dhe provon të sigurohesh që gjithçka të shkojë si duhet, natyrisht ti nuk mund të jesh

gjithmonë në terrenin tënd. Komenti im mbi burrin e mbretit në Facebook provokoi një përgjigje të nxehtë nga një politikan emri i të cilit nuk duhet të përmendet, por nuk ishte më thjesht një status Facebook-u ku nuk shihej ajo që nga dikush u pa si komedi e dikush si ironi. Ironia është koncept të cilin kam frikë ta them se nuk është i mirëkuptuar nga shumica dërmuese e njerëzve në këtë pjesë të botës, pa marrë parasysh nëse është etniteti i gjuhës amtare, dhe pastaj kishte më shumë nervozë se sa argëtim (qeshë).

Anna Di Lellio: Në fakt, dua të ju pyes, ju keni punuar këtu për një kohë të gjatë dhe mund të bëni dallimin në mes të qenit gazetar dhe të qenit zyrtar i Kombeve të Bashkuara, çfarë ka ndryshuar në marrëdhënien tënde me njerëzit nga këtu, ekzistojnë dy kategori të njerëzve ndërkombëtarë në Kosovë dhe më duket se është kështu në të gjitha misionet, a ka ndryshuar ndonjë gjë dhe si ka qenë, si do ta pershkruanit marrëdhënien tuaj me njerëzit lokal?

Jolyon Naegle: Problemi im i parë ishte... marrëdhënia ime me vendasit nuk ndryshoi. Unë jam ky që jam, ata që më kanë njohur më parë më kanë pranuar për atë që jam. Problemi më i madh ishte me kolegët e mi nga Kombet e Bashkuara të cilëve iu deshën vite e disa të tjerë nuk arritën kurrë të më shohin më shumë se thjesht një gazetar të cilit nuk mund t'i besonin, i cili do të derdhte bizelet në një mënyrë apo një tjetër dhe në fakt më kujtohet që brenda javës së parë ose dy javëve të para, mbikëqyrësi im më mori anash, njëri nga mbikëqyrësit e mi, diplomat gjerman më mori anash dhe më tha, "Nuk je më gazetar, nuk do të tregosh atë që ke dëgjuar në atë dhomë..." Pse do të bëja një gjë të tillë, sidoqoftë kaq kishte, informacioni është rehati e vlerësueshme në një shoqëri të mbyllur apo në një shoqëri të pazakontë si kjo e cila është nën administrimin ndërkombëtar dhe ne, ne UNMIK-u ishim poashtu në ato ditë, nëse duam të jemi krejtësisht brenda pikturës së asaj që po ndodhte. Po, përpos që kemi lexuar gazetatat me shumë kujdes në mes rreshtave, përpos që kemi mbajtur kontakte me politikanët dhe këshilltarët e tyre, unë gjithashtu kam mbajtur kontakte me disa gazetarë, edhe pse më duhet të them që ishin shumë të paktë sepse shumica dërmuese e tyre nuk i kuptonon bazat e atyre ditëve të konfidencialitetit dhe nëse iu thoshe diçka, emri yt paraqitej në shtyp dhe gjithçka ishte aty, nuk kishte mënyrë që të mbetesh në prapavijë e të tjerë. Por ata që punonin për media vendase ndërkombëtare, nëse ata kishin ndonjë pyetje dhe nuk do ta mernin përgjigjen direkt nga zyra e UNMIK-ut për informacion publik apo sido që quhej ajo, e pati ndryshuar emrin shumë herë, ata do të mund të më thërrisnin mua dhe unë do t'iu tregoja, çfarëdo që dija, vetëm në rast se ajo ishte diçka... dhe anasjelltas, unë mund t'iu bëja pyetje nëse kishin ndonjë informacion që unë nuk e kisha, veçanërisht në, në, përgjatë dhunës së marsit kur ata kishin pasur njerëz anëmbanë e unë nuk kisha pasur, edhe ne kishim njerëz por nuk pranionim raportimin që na nevojitej sepse njerëzit në terren me të cilët ne punonim ishin nga departamenti civil. Departamenti, si quhej në ato kohë, administrata - Dy Shtylla. Kështu që, ata ishin shumë afër informacionit, shkova direkt tek SORG, asnjëri prej tyre nuk kishte ardhur në zyrën e marrëdhënieve politike dhe unë me të vërtetë nuk kisha marrë asnjë raport nga terreni e nuk e dija çfarë po ndodhte për disa kohë në terren, të gjithë informacionin e mora nga kontaktet me gazetarë dhe unë iu tregova atë që shihja brenda misionit dhe ata nuk tradhtuan

konfidencialitetin e as nuk abuzuan me informacionin, ata punuan në një mënyrë shumë të përgjegjshme dhe të matur.

Anna Di Lellio: A thanë pastaj Kombet e Bashkuara se kishin pasur sukses në diçka, ju thatë se UNMIK-u në përgjithësi e ka përmbushur mandatin e vet me, e dini, probleme, ju shprehët...

Jolyon Naegele: E dini, 14 vjet është kohë e gjatë, dhe në dy vitet e fundit nuk është se ka pasur ndonjë mundësi, sepse ajo çfarë ne po bëjmë, çfarë përgjegjësi kemi ne realisht përpos të provojmë ta portretizojmë vetveten si diçka që nuk jemi më, në vitet e fundit. Viteve të fundit nuk kemi bërë asgjë përpos që iu kemi tërhequr vërejtjen Kombeve të Bashkuara dhe New York-ut dhe në Prishtinë kemi tentuar të rimarrim veten në fusha të caktuara të ligjit, kështu nuk funksionon. Kjo ka devijuar, po iu shërben interesave partikulare, të veçanta, karrierizmit të individëve të caktuar. Do të ketë një goditje të madhe nga qeveria, ky nuk është Mali as Haiti, ky është shtet që nuk dëshiron të bëjë asgjë që në ndonjë mënyrë do të rrezikonte sovranitetin e vet. Kështu që, mua praktikisht më thanë të hesht ose më injoruan, por u dëshmuua që unë kisha të drejtë, kështu që kjo ishte një lloj kënaqësie, dhe mendoj se kam pasur më shumë ndikim në epokën e SRSG në Evropë sesa në Afganistan. Frustrime të ndryshme përgjatë viteve, domethënë, më duhet t'iu kthehem shënimeve të mia, por, po, kishte raste. Ka pasur një shumëllojshmëri gjërash që janë përfshirë në dialogje, qoftë për të qenë në komisionin qendror të zgjedheve, apo në atë se si të raportohen çështjet në New York, çfarë detajesh duhej shtuar, piktura e plotë e asaj se çfarë këshillash duhej t'i jipeshin një SORG para takimit me zyrtarët këtu apo në Beograd, apo në vizitat e tij nga vendet tjera, natyrisht.

Anna Di Lellio: Por a ke frikë se Kombet e Bashkuara mendonin se ju ishit me vlerë këtu sepse e dinit vendin, a mendoni se për një paqeruajtës, në qoftë se dikush është i përfshirë në punë të tilla, është e rëndësishme të dijë vendin mirë apo ndoshta mund të jetë më përfituese nëse i jipet një shikim i freskët?

Jolyon Naegele: Funksionon në dy mënyrat, askush, nuk mund të presësh nga askush të dijë, e ke parasysh, duhet të kuptosh kontekstin përndryshe je i dënuar të bësh gabime të mëdha. Dhe të kuptuarit e kontekstit nënkupton udhëheqje, siç thuhet në gazetari, duhet të jesh në hap me kohën me gjithçka që ka ndodhur në të kaluarën, duhet të dish kontekstin, nëse nuk e di kontekstin, nëse nuk e di pse jemi këtu dhe pse jemi ende këtu dhe pse nuk duhet të jemi këtu më, atëherë ndodhë që mund të jesh duke shpenzuar kohën tënde dhe kohën e shumë të tjerëve. Me të vërtetë duhet të kuptosh nga ku kemi ardhur, çfarë po provojmë të arrijmë këtu tani dhe pse jemi ende këtu.

Anna Di Lellio: Pra, nuk është çështja shumë kush jeni por sa i përgatitur jeni të përballeni me situatën, po bëni komente rreth asaj se çfarë keni qenë për SORG të ndryshëm, po mendoj për të gjithë ata, a kanë qenë të gjithë...

Jolyon Naegele: Shtatë, kam punuar për shtatë por nuk kam punuar për tre të parët.

Anna Di Lellio: Në rregull pra ju punoni për shtatë SRSG, pra a mund të na tregoni diçka për dallimet, domethënë, çfarë ka funksionuar dhe çfarë nuk ka funksionuar, në kuptimin e asaj se sa të përgatitur ishin ata, prej nga po vinin ata për t'u përballur me këtë mision i cili është disi i komplikuar?

Jolyon Naegle: Po, në rregull, ata që ishin të nominuar nga Shtetet e Bashkuara, të gjithë prej tyre përpos dy të fundit, kishin masterë të shumëfishtë nga Brukseli dhe New York-u. Ata ishin të irrituar në atë kohë por nga ajo që disa e përceptuan si mikro menaxhim nga New York-u, ata ishin tërë kohën në telefon me kryeqytetet e tyre, qoftë Roma, Berlini, Konpenhaga, Helsinki apo Brukseli dhe ajo komplikonte gjërat për ta dhe për udhëheqjen e misionit si dhe për zyrën kryesore në të kuptuarit e asaj që po ndodhte këtu dhe ata ishin jorehat me materialin i cili iu jipej. Kofi Annan, sekretari general caktonte njerëz, të cilët ai mendonte se ishin të përshtatshëm për fazat e ndryshme të misionit, ai kishte nevojë... fillimisht humanitar, pastaj ai kishte nevojë për dikë me një prapavijë disi ushtarake, i pari ishte... dy të parët ishin humanitarë, pastaj i treti kishte qenë ministër i mbrojtjes në Danimarkë, pastaj ai kishte një siguri kombëtare pas 9/11. Michael Steiner, i cili kishte qenë këshilltar kombëtar për siguri i kancelarit gjerman, pastaj erdhi Ban Ki-Moon në skenë dhe ne kishim.... Oh, prit, ende ishte Holkery sepse ish kryeministri, sepse Kofi Annan dëshironte qëndrime mbi këtë pozitë pas, pas Steiner. Por pastaj erdhi Ban Ki-Moon, dhe pastaj pamë Jesen Petersen, dikë nga brenda Kombeve të Bashkuara por që ishte humanitar dhe mendonte me zemrën e tij edhe kur mernte vendime politike e kjo ishte e meta e tij, ai u përçoll nga Joachim Rueker, i cili ishte një teknokrat politik, ish kryetar komune që mbante një post goxha të lartë në ministrinë gjermane të punëve të jashtme e i cili kishte qenë udhëheqës i shtyllës rindërtuese të Bashkimit Evropian, kështu që ai tashmë kishte disa vjet përvojë, nuk erdhi verbërisht këtu.... Steiner poashtu kishte përvojë duke qenë përfaqësues i lartë në Sarajevë, ai e njihnte rajonin, nëse jo Kosovën. Jesen Petersen kishte qenë poashtu udhëheqës i zyrës së UNCHR në Shkup.

Lamberto Zannier ishte një negociues armësh por gjithashtu kishte udhëhequr zyrën e NOVSI për minoritetet, dhe mendoj se ishte një diplomat, dhe pastaj ky ishte fundi i interesit të Bashkimit Evropian për këmbëngulje për, për, për të pasur një gisht në UNMIK, apo në UNMIK sepse e kuptuan se EULEX-i, këto janë Shtetet e Bashkuara, zyra EUSR, kështu që nuk na duhen. Të gjithë kishin bërë gabimin e njëjtë duke i përfshirë rusët kur u tërhoqën këtu, të kam parë ty personalisht të zhvendosur në zyrën e Ahtisaarit. Të gjithë e kanë keqlllogaritur atë se UNMIK-u thjesht do të largohej dhe e kishim dy SRSG afganë. Njëri prej të cilëve ishte rojë udhëheqëse dhe kishte punuar në sistemin e Kombeve të Bashkuara për 20 vite e pastaj kishte filluar në UNMIK, kështu që ai e njihnte sistemin nga brenda dhe jashtë, gjë kjo që kishte përfitimet e veta por poashtu edhe grackat e mundshme. SORG aktual është poashtu afgan, ai ishte përfaqësues i shtetit të vet në New York për shtatë vjet dhe udhëhoqi komitetin për reforma të Këshillit të Sigurimit, kështu që ai e njeh strukturën e Kombeve të Bashkuara aq mirë sa, edhe nëse nuk e ka ditur si funksionon sistemi në fillim, tashmë e ka të qartë.

Anna Di Lellio: Dua të ju pyes, sa e njihni Kosovën tani pas 14 vjetësh?

Jolyon Naegele: Kjo është një enigma, kjo është aq mirë, po mendoj, bazuar në atë sa mund ta bëj unë veten të kuptueshëm, shqipja ime është e keqe sepse këtu unë jam në një fluskë anglisht-folëse, këtu ka mjaft njerëz që flasin anglisht, gjermanisht ose serbisht apo çfarëdo gjuhe me të cilën mund t’ia dal. Kam pasur kolegë vendas këshilltarë shumë të mirë të cilët më kanë mbajtur brenda fotografisë sa i përket asaj se si gjërat funksionojnë këtu. Kur kam ardhur këtu për herë të parë, kam udhëtuar shumë, sa më lart që lëvizë brenda një sistemi, aq më të largët mbesin ata nën ty dhe gjithashtu ata të thonë, “Shiko, gjëja e fundit që duhet të bësh është të bësh miq brenda sistemit,” dhe ata nuk mund të të mbajnë në largësi të krahut. Unë kam gjetur, e dini, ftoja njerëz për darkë gjithë kohës dhe jo, mua më pëlqen të gatuj, por askush nuk më ftonte mua dhe nuk e di a isha shumë turpërues në atë që mund të prodhoja apo shumë turpërues intelektualisht, apo thjesht shumë turpërues për shkak të rangut tim, nuk e di, mbase të trija së bashku por kështu jam ndjerë disi i izoluar në atë aspekt, kjo është, siç e kam thënë edhe në një fjalim që e ka dhënë Holkery në vitin 2003, ose në fillim të vitit 2004.

Është një stagnim, sigurisht kishte qenë kështu në epokën e Jugosllavisë, dhe në shkallën e gjërave edhe në rajon, domethënë kjo është provincë, ka qenë e pavarur tash e nëntë vjet por kurrë nuk ka pasur histori të pavarësisë, nuk e ka dhe sapo ka filluar të ketë një elitë politike të trajnuar ndërkombëtarisht. Por, për arsye se politikanët që kanë mbajtur pushtetin kanë përvojë të kufizuar ndërkombëtare në kuptimin e edukimit dhe bëjnë gjithçka që t’i mbajnë ata që kanë diçka të tillë në një distancë ose krejtësisht jashtë fotografisë, dhe kjo po ndryshon, por po ndryshon tepër ngadalë. Ka telashe të tilla si qyteti kundër periferisë apo “katunar” kundër “qytetar” të cilat ende nuk janë tejkualuar, po mendoj, dikush do të mund të ishte shumë mashtrues dhe të thotë se kjo është republik e “katunarve” por kjo nuk është e drejtë, dhe ky është një thjeshtëzim i tepruar por e njëjta do të ishte e vërtetë për Serbinë, Bullgarinë, Malin e Zi, Shqipërinë, Bosnjën e të tjerë. Është problem i rajonit dhe është trashëgimi e të kaluarës së tij osmane, nëse ka trashëgimi të epokës socialiste e të tjerë... dhe prej asaj del diçka për ndryshimin e të cilës duhen gjenerata, kjo është diçka që nuk zgjidhet nga misioni i Kombeve të Bashkuara apo misionet paqeruajtëse të cilat synojnë t’i kthejnë gjërat në formë brenda disa vjetësh.

Anna Di Lellio: Por kam një pyetje nga një rrëfim që më keni treguar, nga ajo që di prej jush është se ju gjithashtu e njihini Kosovën shumë mirë, praktikisht keni ecur gjithkund.

Jolyon Naegele: Jo, ka ende qoshe të Kosovës nëpër të cilat nuk jam ngjitur ose nuk kam vozitur, nuk janë shumë por po, po mendoj ka vende, e dini, kurrë nuk kam shkuar në rrugët nga Llukari në Kamenicë, ndoshta kam kaluar nëpër disa prej tyre, por praktikisht në Kosovën lindore për tek kufiri serb, në atë territor. Dhe është i koordinuar për mua pjesërisht sepse ajo pjesë është shumë pak e populluar dhe rrugët deri së fundmi kanë qenë shumë të këqija, kështu që kurrë nuk kam gjetur arsye për të shkuar atje.

Anna Di Lellio: Por ke bërë gjithçka tjetër?

Jolyon Naegele: Ekzistojnë shumë qoshe në të cilat do të doja të ngjitesha, male nëpër të cilat nuk kam qenë e që do të doja të shkoja. Male të cilat i kam shikuar për kohë të gjatë, do të doja të shkoja por nuk kam shkuar, vende problematike të cilave iu jam shmangur në mënyrë që të mos futesha në telashe, këto janë në kufirin me Maqedoninë, në lindje të Hanit të Elezit. E dini, në këtë pjesë të Hanit të Elezit dhe e njëjta vlen edhe për pjesë të caktuara të Maqedonisë prapa Tetovës në kodra dhe ato vende, e di ku të shkoj nëse dua të kaloj një ditë të mirë duke u ngjitur. E di ku janë vendet më të bukura të Kosovës dhe ekzistojnë ende disa prej tyre në të cilat nuk kam pasur mundësi të shkoj, sepse për të shkuar në to duhet planifikim, vetëm nëse merr një tendë me vete sepse rrugët nuk të dërgojnë aty, e dini, duhet të shkosh vetë me dy këmbët e tua, kështu që ndoshta nuk mund ta kalosh të gjithën në një ditë të vetme dhe unë nuk jam njeri i kampingut në këtë moshë kështu që...

Anna Di Lellio: Nëse nuk iu pengon, diçka më personale, po përmendni një bashkëshorte, a keni bashkëshorte?

Jolyon Naegele: Po, bashkëshortja ime, mirë. Jam martuar në vitin 1991 me një arkitekte çeke dhe kishim një vajzë, e u ndamë në vitin 2002. Një vit para se të vija këtu, dhe kur ia pata përmendur këtë gjë shefit tim më vonë, pak pasi kisha ardhur, ai tha, “Po, shumë njerëz janë në të njëjtën situatë sikur ti,” dhe pas disa vitesh e dëgjova se UNMIK-u njëmend mendon se nuk duhet martuar në Kosovë. Kështu që, po, esencialisht isha beqar këtu për disa vite dhe edhe kjo gjë më dhuroi një perespektivë të caktuar, dhe ende pranoj perspektiva rreth jetës së grave kosovare dhe të qenit i huaj nuk përbën domosdoshmërisht një plus. Domethënë, kam dëgjuar shumë gra tek thonë, “Oh, kurrë mos u martoni me një burrë Kosovar,” edhe gratë kosovare thonë diçka të tillë, por unë gjithashtu dëgjoj, kam dëgjuar prej një njeriu, në rregull ajo ishte një shqiptare nga Serbia e jugut e cila tha, “E di çfarë do t’i mërziste shumë prindërit e mi?” I thashë, “Çfarë, nuk kam propozuar asgjë përtej kësaj nate,” dhe ajo tha, eh po, ato menjëherë mendojnë se ne ikim dhe kush do të kujdeset për fermën, për shtëpinë, unë të kisha thënë se nuk e kam ngritur asnjëherë atë çështje (qeshë). Unë thjesht kisha kërkuar një natë, ajo gjë kishte kuptim sepse nëse motra e saj do ta kuptonte, ajo do t’iu tregonte prindërve, dhe ju e dini që kjo është shoqëri mjaft e mbyllur, lidhje shumë të forta familjare dhe nëse dikush do të zbulonte se ti ke diçka me një amerikan, supozimi është se ajo do të përfundojë në martesë dhe ti do të zhvendosesh për në Amerikë. Eh po, unë kam jetuar jashtë amerikës për 36 vjet, kështu që ky është një episod pothuajse i pamundur, por mund të them se shkoj në Pilates tre deri në pesë mbrëmje në jave dhe nganjëherë përpos instruktorit, unë jam i vetmi burrë në dhomë dhe të tjerat janë gra nga mesi i të 20-tave deri në të 60-tat e vonshme.

Kryesisht gratë shqiptare, shqiptaret nga Kosova të cilat përbëjnë 95 përqind të grave, janë disa raste të grave ndërkombëtare por gratë shqiptare ose më shikojnë direkt në sy sikur nuk ekzistoj pa marrë parasysh a kam unazë apo jo, nuk ka asnjë tentim, përpos rasteve që kanë jetuar jashtë shtetit për kohë të gjatë, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara, ato flasin. Nuk mendoj se është problem gjuhësor, as turp, është thjesht, nuk duan të shkojnë aty, nuk e di, ato thjesht nuk janë duke veshur vëllë, ato janë duke veshur bluza të lira kështu që (qeshë), kjo do të thotë, nuk ia ke idenë por nuk e di, është përvojë e çuditshme. Dhe po, çdo grua evropiane perëndimore apo lindore, ose amerikane veriore,

latino amerikane që shkon në atë ambient, nuk ka asnjë problem për të filluar një bisedë apo për të pasur një bisedë me mua, për të më përshëndetur, nuk ka asgjë, asnjë përshëndetje, më shohin në rrugë duke ardhur dhe ato janë duke ardhur nga drejtimi tjetër, ne shkojmë në të njëjtën drejtim, nuk ka njohje, mirënjohje, asgjë dhe këto janë kryesisht gra inteligjente, po mendoj, e din nga klasat e bisedave, nga klasat udhëheqëse, ato nuk komunikojnë, nuk ka kontakt me sy me asgjë, mua nuk më duket ofenduese, është problemi i tyre, jo imi. Por më duket e çuditshme në këtë moshë, por në rregull, ti e di që nuk jemi në Amerikë, nuk mendoj se jam i moshuar. Kam shkuar në Pilate për katër vjet por është e çuditshme, mund t'i numroj gratë shqiptare me të cilat kam shkëmbyer diçka më shumë se një përshëndetje këtu me ndoshta vetëm një gisht, për katër vjet.

Anna Di Lellio: Por është në rregull sepse tani jeni i martuar.

Jolyon Naegele: Po, kam shpëtuar. Ndërkohë që ishim tek një mik i imi të cilin e kam njohur që para se të filloja të vija në Kosovë, poashtu çek, etnolog i fokusuar në indogjenët e Sberisë, Siberisë qendrore, por i cili punon si redaktor i një magazine mbi jetesën e shëndetshme, dhe ai ka qenë me mua për rreth dy vitet e fundit duke redaktuar, duke iu falenderuar shërbimeve të përhershme të IPKO-s, jam i aftë të funksionoj nga këtu kështu që jeta ime ka ndryshuar paksa dhe nuk dal në ngjitje ashtu siç kam bërë më parë. Më parë isha në formë më të mirë duke iu falenderuar Pilates, por ajo është këtu me dy fëmijët e saj nga martesja e parë dhe fëmijët në një moshë të caktuar nuk janë shumë të mirë për t'i futur në makinë dhe kaluar një ditë larg. Kështu që nuk udhëtojmë aq shumë sa do të doja, por ata janë të lumtur në një shkollë ndërkombëtare dhe nuk dyshoj se do të marin edukimi po aq të mirë sa në Pragë, kur do të kthehem...

Anna Di Lellio: Dhe ata po shoqërohen, apo jo?

Jolyon Naegele: Po, po shoqërohen.

Anna Di Lellio: Vetëm edhe një pyetje të fundit, a do të zhvendoseni tani në Republikën Çeke, në Pragë, a do të lini miq këtu?

Jolyon Naegele: Natyrisht, natyrisht, njerëz me të cilët kam punuar për 14 vjet dhe të cilëve iu besoj, të cilët më pëlqejnë dhe i respektoj. Të tjerë me të cilët nuk kam punuar por me të cilët jam njohur që kur jam zhvendosur këtu, të gjithë do më mungojnë natyrisht, dhe me ta do të mbesim në kontakt duke iu falenderuar Facebook-ut, e dini. Kështu që, ata do të dijnë ku jam, unë do të di ku janë ata dhe nëse ndonjëherë kthehem në këto pjesë, jam i sigurt se do të takohemi përsëri bashkë. Nuk po largohem nga Kosova me ndjenja të hidhura, jo, nuk jam larguar nga Kombet e Bashkuara para tri javës me ndjenja të hidhura, kam arritur moshën e kërkuar për pensionim për njerëzit që janë punësuar para vitit 2014, jam jashtë, e kam ditur që në momentin që jam punësuar, kurrë nuk kam menduar se do të qëndroja kaq gjatë, të gjitha gjërave të mira iu vjen fundi. Nuk e di sa dimrave të tjerë të Prishtinës dhe Obiliçit do të isha në gjendje t'iu mbijetoja nëse do të qëndroja këtu. Po të më ofrohej të qëndroja deri në moshën 65 vjeçare, me siguri nuk do të pranoja sepse gjatë dimrit, kualiteti i ajrit këtu po bëhet keq e më keq në mes muajve Nëntor dhe Shkurt.

Anna Di Lellio: Ndonjë gjë tjetër që do të dëshironit të shtonit, diçka që nuk iu kam pyetur e që ju mendoni se është mirë të thuhet?

Jolyon Naegele: Asgjë, asgjë nuk më vjen në mendje. Jam i sigurt që sapo të dal nga dera, njëzetë gjëra do të më ndodhin mua dhe ty... shiko, kjo është shoqëri e cila ka qenë e viktimizuar për shekuj, përgjatë shekeullit të fundit, dhe vazhdon të jetë e tillë dhe zgjedhjet e lira, parti elektorale e të tjerë, nuk ka parti. Politika është problematike çdokund, dhe Kosova nuk është përjashtim. Shpesh më pyesin nëse po të isha në këtë shtet apo në ndonjë shtet, për kë do të votoja, cilën parti do ta votoja? Dhe përgjegjja ime është se jam gjithmonë me fat që nuk jam në atë pozicion që më duhet të marrë një vendim. Njerëzit e OJQ-ve të cilët dëshironin t'i futeshin politikës më kanë pyetur për mendimin tim rreth themelimit të partive të tyre të reja dhe kjo ka vazhduar prej kur kam filluar këtu dhe këshilla ime ka qenë, "Gjeni një parti që është të paktën afër me atë që ti mendon se mund të funksionojë për të ndryshuar gjërat. Themelimi i partisë tuaj është mënyra më e shpejtë për bankrotim. Nuk duhet të themeloni parti, përpos nëse keni paratë e Pacollit, nuk mund ta përballoni," këtë ia kam thënë Enver Hoxhës, dhe për befasinë time ai ka zgjedhur PDK-në. Kjo kishte qenë këshilla ime edhe për njerëz që përfunduan duke kërcyer në Vetvendosje!, nëse mund ta ndryshoni atë nga brenda, paçit fat! Nuk kemi diskutuar as për Vetvendosjen!, kështu që...

Anna Di Lellio: A na duhet të diskutojmë për të?

Jolyon Naegele: Jo (qeshë), ata, mendoj sa më pak që themi për ta... nuk është se do të them diçka që nuk e kanë thënë njëqind njerëz para meje, dyshoj.

Anna Di Lellio: Faleminderit, faleminderit shumë për kohën tuaj.

Jolyon Naegele: Kënaqësia ime!